



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 38/2021 regjistër (JR)
Datë 14.07.2021

Nr. 26 i vendimit
Datë 03.07.2023

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

| | |
|------------------------|------------------|
| Rezarta Schuetz | Kryesuese |
| Ina Rama | Relatore |
| Albana Shtylla | Anëtare |
| Natasha Mulaj | Anëtare |
| Sokol Çomo | Anëtar |

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 03.07.2023, ditën e hënë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Gerrit Sprenger, me Sekretare Gjyqësore Ina Xhetani, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUESE: Subjekti i rivlerësimit, znj. Gentiana Xhelili, gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Vlorë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 369, datë 21.04.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, Dh, E, Ë dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; nenet 6 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, shqyrtoi pretendimet e kërkimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim, dhe në parashtrimet para seancës gjyqësore, dëgjoji relatorin e çështjes, gjyqtaren Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Gentiana Xhelili (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex-officio*, për shkak të ushtrimit të funksionit të gjyqtarës në Gjykatën e Administrative Shkallës së Parë, Vlorë, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”).
2. Për subjektin e rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) ka zhvilluar hetime për 3 (tri) kriteret e vlerësimit, përkatësisht për vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Në zbatim të përcaktimeve të neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), Komisioni ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), sipas neneve 31-33 të ligjit nr. 84/2016, nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”), sipas neneve 34-39 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”), sipas neneve 40-44 të ligjit nr. 84/2016.

2.1. ILDKPKI-ja, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë, i ka dërguar Komisionit raport kontrolli¹, në të cilin konkludohet se: *Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja konstaton se për subjektin e rivlerësimit, znj. Gentiana Xhelili:*

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me të ardhurat e prindërve të bashkëshortit dhe për pagesën e tatimit në burim për të ardhurat nga qiradhënia;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

¹ Me shkresën nr. {***} prot., datë 14.09.2018.

2.2. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me qëllim identifikimin nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport² për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit, znj. Gentiana Xhelili: (a) ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramentit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar; (b) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara prej saj në deklaratën për kontrollin e figurës; (c) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimin të organizuar. Si konkluzion, grupi i punës ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Gentiana Xhelili

2.3. KLGj-ja, për subjektin e rivlerësimit, ka hartuar raportin për analizimin e aftësive profesionale, të cilin ia ka përcjellë Komisionit³.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), me vendimin nr. 369, datë 21.04.2021, ka vendosur: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Gentiana Xhelili, gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Vlorë [...].*
4. Vendimi i Komisionit për subjektin e rivlerësimit, znj. Gentiana Xhelili, është marrë bazuar në kriteret e vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe në vlerësimin e aftësive profesionale, për të cilat është konkluduar se:
 - a) **Në lidhje me vlerësimin e pasurisë:** Në përfundim të shqyrtimit të kriterit të pasurisë, trupi gjykues i Komisionit, bazuar në analizën e mësipërme, arrin në këto konkluzione:
 - i. Në lidhje me kursimet cash, me vlerë 4.000 euro, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e gjendjes së likuiditeteve cash në vlerën 408.963 lekë, duke u gjendur brenda parashikimeve të germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.
 - ii. Lidhur me kursimet nga paga dhe qiraja e apartamentit, në shumën 133.168,87 lekë, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e të ardhurave nga qiraja e apartamentit, në shumën 1.470.000 lekë, në pronësi të prindërve të bashkëshortit, të ardhura që kanë shërbyer si burim për krijimin e blerjes së kuotave në fondin e investimit Raiffeisen Prestigj, duke u gjendur brenda parashikimeve të germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

² Me shkresën nr. {***} prot., datë 2.11.2017, deklasifikuar me vendimin nr. {***}, datë 16.1.2020, të KDZH-së.

³ Me shkresën nr. {***} prot., datë 06.02.2020.

iii. Lidhur me kursimet cash në shumën 900.000 lekë, të krijuara me burim të ardhurat nga qiraja e tokës bujqësore – subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë gjendjen cash në deklaratën e pasurisë vetting të vitit 2017 dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e të ardhurave nga qiraja e tokës bujqësore, në vlerën 1.200.000 lekë, të ardhura që kanë shërbyer si burim për krijimin e blerjes së kuotave në fondin e investimit Raiffeisen Prestigj, duke u gjendur brenda parashikimeve të germave “a” dhe “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

iv. Lidhur me blerjen e kuotave në fondin e investimit Raiffeisen Prestigj, vlera 7.556.000 lekë – subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për blerjen e kuotave në fondin e investimeve, në vlerën 3.552.438 lekë, duke u gjendur brenda parashikimeve të germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

v. Në përmbledhje të konkluzioneve më lart, bazuar në analizën financiare për pasuritë, shpenzimet dhe të ardhurat e ligjshme të subjektit dhe të personave të lidhur, për vitet 2009 - 2016, subjekti i rivlerësimit ka balancë negative për blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve në vlerën (-) 3 545 602 lekë, duke u gjendur në kushtet e germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, bazuar në pikat 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe në gerrat “a” dhe “b” të pikës 5 të nenit 33 dhe në pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm në kriterin e pasurisë.

b) **Në lidhje me vlerësimin e figurës:** Në përfundim të hetimit administrativ, si dhe të vlerësimit të provave dhe shpjegimeve të subjektit, Komisioni vlerëson se subjekti ka plotësuar saktë deklaratën e kontrollit të figurës, si dhe nuk ka kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar, në kuptim të pikës 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, duke konkluduar se subjekti i rivlerësimit, znj. Gentiana Xhelili, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

c) **Në lidhje me vlerësimin profesional:** Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka mangësi në drejtim të aftësive organizative, si: për të përballuar ngarkesën e punës; plotësimin e standardeve minimale kohore; kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje në rendimentin e përfundimit të çështjeve gjyqësore; moskryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor; për mosshmangien e seancave gjyqësore joproductive; për të mos miradministruar dosjet gjyqësore, duke u bazuar në rregullshmërinë, plotësinë dhe saktësinë e dokumentacionit të dosjes, ka aftësi minimale kualifikuese. Mangësitë e konstatuara më lart, Komisioni vlerëson se nuk mund të ngrihen në nivelin e shkarkimit sipas pikës 4 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, por duhen marrë në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes, duke u gjendur në kushtet e pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

III. Shkaqet e ankimit

5. Kundër vendimit nr. 369, datë 21.04.2021, të Komisionit, ushtroi ankim⁴ subjekti i rivlerësimit, znj. Gentiana Xhelili, për shkaqe që lidhen me procesin e rregullt ligjor, kriterin e vlerësimit të

⁴ Ankimi është administruar në Komision me nr. {***} prot., datë 06.07.2021.

pasurisë, si dhe kundërshtitë lidhur me konkluzionin se gjendet në kushtet e cenimit të besimit të publikut, duke kërkuar ndryshimin e këtij vendimi dhe konfirmim në detyrë. Në vijim të këtij arsyetimi, do të gjejnë trajtim fillimisht shkaqet e ankimit të cilat u adresohen kriterëve të rivlerësimit për shkak edhe të vendimit përfundimtar të marrë nga trupi gjygues.

A. Shkaqe ankimi që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë

6. Në mënyrë të përmbledhur, këto shkaqe ankimi janë si më poshtë vijojnë.

6.1. Subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit se ajo dhe personat e lidhur gjenden në mungesë burimesh të ligjshme financiare për krijimin e gjendjes së likuiditeteve *cash* në shumën 4.000 euro, të deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, është jo i drejtë dhe i gabuar, pasi në analizën financiare nuk janë përfshirë: (i) të ardhurat e siguruar nga shitja e automjetit në vitin 2013, i cili ishte fituar nëpërmjet dhurimit nga bashkëshorti; (ii) të ardhurat e siguruar nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz”, në vitin 2016.

6.2. Subjekti i rivlerësimit kundërshton si jo të drejtë dhe të bazuar në ligj konkluzionin e Komisionit për pasurinë likuiditet, të ndodhur në llogarinë bankare në emër të bashkëshortit në Raiffeisen Bank, në vlerën 133.168,87 lekë, për të cilën ka konkluduar se subjekti dhe personi i lidhur kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme, duke mos njohur si të ligjshme të ardhurat nga qiraja e apartamentit në pronësi të prindërve të bashkëshortit, në shumën 1.470.000 lekë, të ardhura që gjithashtu kanë shërbyer si burim për blerjen e kuotave në fondin e investimit Raiffeisen Prestigj. Për këto të ardhura, subjekti i rivlerësimit pretendon se: (i) ato janë krijuar nga burime të ligjshme në kuptimin që ligji “Për tatimin mbi të ardhurat” jep për to; (ii) janë paguar detyrimet tatimore duke qenë se neni D i Aneksit të Kushtetutës nuk e lidh pagesën e tatimeve me një afat të caktuar; (iii) detyrimi për pagimin e tatimeve për të ardhurat nga qiradhënia e apartamentit nuk ka qenë i subjektit, por i prindërve të bashkëshortit, të cilët, sipas ligjit nr. 9049, datë 10.03.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, nuk kishin detyrimin për deklarim dhe se ata janë konsideruar si persona të lidhur vetëm me ligjin nr. 84/2016.

6.3. Subjekti i rivlerësimit kundërshton si jo të drejtë dhe të bazuar në ligj e në situatën faktike konkluzionin e Komisionit se nuk ka deklaruar saktë gjendjen *cash* prej 900.000 lekësh në deklaratën e pasurisë *vetting* të vitit 2017, dhe se ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e të ardhurave nga qiraja e tokës bujqësore në vlerën 1.200.000 lekë, të ardhura që kanë shërbyer si burim për krijimin e blerjes së kuotave në fondin e investimit Raiffeisen Prestigj.

6.4. Subjekti i rivlerësimit kundërshton si jo të drejtë e të bazuar në situatën faktike analizën financiare të kryer për vitet 2006-2008 dhe 2009-2016 nga Komisioni për pasurinë likuiditet në vlerën prej 7.550.000 lekësh, të përdorur për blerjen e kuotave në fondin e investimit Prestigj pranë Bankës Raiffeisen.

B. Shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale dhe të cenimit të besimit të publikut

7. Në mënyrë të përmbledhur, këto shkaqe ankimi janë si më poshtë vijojnë.

7.1. Subjekti i rivlerësimit e konsideron si tërësisht të padrejtë dhe të paargumentuar konkluzionin e Komisionit se ka mangësi në drejtim të aftësive organizative për të përballuar ngarkesën e punës, plotësimin e standardeve minimale kohore, kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, si dhe rendimentin e përfundimit të çështjeve gjyqësore.

7.2. Subjekti i rivlerësimit kundërshton si jo të drejta dhe jo të vlerësuara sipas parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit konkluzionet e Komisionit lidhur me çështjen administrative me nr. {***}, datë 28.10.2014 regjistrimi, që i përket paditësit D. H. kundër palës së paditur ZRVPP-ja Vlorë dhe Komuna {***}, Vlorë.

7.3. Subjekti i rivlerësimit kundërshton si jo të drejta, të bazuara në ligj e jo të trajtuara sipas parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit konkluzionet e Komisionit për çështjen e gjykuar prej tij, me palë paditëse E. K., E. B., V. B., K. B.(trashëgimtarët të z. A. B.), e palë të paditur ZRVPP-ja Vlorë, ZQRPP-ja Tiranë, person i tretë Avokatura e Shtetit Vlorë.

7.4. Subjekti i rivlerësimit kundërshton si jo të drejta dhe të bazuara në ligj konkluzionet e Komisionit lidhur me analizimin e ankesave të paraqitura pranë KLGj-së, që kanë të bëjnë me: (i) ankesën e {***}; (ii) ankesën e Bashkisë Konispol.

7.5. Subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk është i drejtë dhe i bazuar në ligj e në situatën faktike konkluzioni i Komisionit se subjekti gjendet në kushtet e cenimit të besimit të publikut sipas përcaktimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

C. Shkaqe ankimi që lidhen me aplikimin e drejtë të ligjit dhe garantimin e procesit të rregullt ligjor

8. Në mënyrë të përmbledhur këto shkaqe ankimi paraqiten si më poshtë vijojnë.

8.1. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni në shqyrtimin e çështjes së tij të rivlerësimit ka kryer shkelje procedurale dhe të parimeve të procesit të rregullt ligjor, të cilat konsistojnë në: **(i)** vendimi i Komisionit është i paarsyetuar dhe se marrja e tij është bërë duke u bazuar në prova që ky organ ka marrë kryesisht dhe pa u dhënë fuqi provuese akteve të paraqitura nga subjekti; **(ii)** në vendimin përfundimtar për dhënien e masës disiplinore, është përdorur si shkak një gjetje për të cilën subjekti pretendon se Komisioni nuk i ka kaluar barrën prove; **(iii)** Komisioni nuk ka zbatuar parimin e kontradiktorialitetit; **(iv)** vendimi për shkarkimin e subjektit ka qenë i paracaktuar, i njëanshëm dhe i padrejtë dhe nuk ka zbatuar parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit; **(v)** vendimi është dhënë nga një trupë e cila nuk ka qenë e pavarur dhe e paanshme; **(vi)** nga ana e Komisionit nuk është respektuar ligji e parimi i sigurisë juridike, pasi konkluzioni për cenim të besimit të publikut është bazuar në

konkluzione që janë gjykuar më parë nga organe kompetente dhe, si të tilla, janë “gjë e gjykuar”.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Shqyrtimi i çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelit

a) Juridiksioni i Kolegjit

9. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion të shqyrtojë (*ratione materiae*) ankimet kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Gentiana Xhelili, ajo bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

10. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh, nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

11. Në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si rregull, shqyrtimi i ankimit të subjektit të rivlerësimit kundër vendimit të Komisionit, kryhet në dhomë këshillimi. Me ankimin objekt gjykimi, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar: *Shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, duke pretenduar se Komisioni nuk pa pranuar shtyrjen e seancës së shpalljes së vendimit pasi është njoftuar nga subjekti që për shkaqe shëndetësore, nuk mundet të jetë prezent dhe se nuk ka avokat që mund të delegojë për ta përfaqësuar.*

11.1 Për këtë qëllim, subjekti i ka bashkëlidhur ankimit, *e-mail*-e të printuara më datë 21.04.2021: (i) *e-mail*-in e datës 21.04.2021, ora 08:51, i dërguar nga adresa elektronike e subjektit (***}) drejt Komisionit, me anë të të cilit, subjekti njofton se për arsye shëndetësore, nuk mund të paraqitet në seancën e caktuar në të njëjtën ditë, në orën 09:30, për shpallje vendimi dhe se për arsye se nuk ka përfaqësues ligjor, kërkon t’i caktohet një ditë tjetër që të jetë prezent personalisht në seancë: (ii) *e-mail*-i i datës 21.04.2021, ora 09:05, me të njëjtën përmbajtje si *e-mail*-i i orës 08:51.

11.2 Nga verifikimi i akteve të fashikullit të hetimit administrativ të krijuar nga Komisioni, konstatohet se aktet/*e-mail*-et që subjekti i bashkëlidh ankimit të tij, nuk përfaqësojnë akte të

reja, pasi ato gjenden të administruara në këtë fashikull si komunikime të subjektit me trupën gjyquese të Komisionit.

11.3 Në këto kushte, pretendimi i subjektit të rivlerësimit për të konsideruar këto akte me cilësinë e provës së re, vlerësohet si i pabazuar, përderisa këto akte gjenden në fashikullin e hetimit administrativ, për pasojë ato nuk kanë statusin e provës së re dhe, si të tilla, nuk mund të detyrojnë trupën gjyqësore të vendosë për marrjen e tyre nëpërmjet kalimit në seancë gjyqësore publike. Gjithashtu, nga vlerësimi që i bëhet pretendimit të subjektit lidhur me mungesën e saj në seancën dëgjimore të shpalljes së vendimit, Kolegji arrin në përfundimin se kjo mungesë nuk ka cenuar asnjë të drejtë procedurale të subjektit. Sipas procesverbalit të seancës dëgjimore të zhvilluar nga Komisioni, rezulton se subjekti ka pasur mundësi të realizojë të plotë mbrojtjen e tij, duke dhënë shpjegime të plota lidhur me kriteret e vlerësimit të pasurisë e të aftësive profesionale, dhe në përfundim ka deklaruar edhe qëndrimin e tij përfundimtar duke kërkuar konfirmimin në detyrë. Mungesa e subjektit në shpalljen e vendimit, vlerësohet se nuk i ka cenuar atij asnjë të drejtë procedurale në drejtim të mbrojtjes dhe as drejtë njohjes me vendimin e arsyetuar e ushtrimin e së drejtës së ankimit ndaj tij. Në këto rrethana, Kolegji çmon se nuk gjendet para asnjë prej situatave të parashikuara prej nenit 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, të cilat do të kërkonin shqyrtimin e kësaj çështjeje në seancë gjyqësore publike me praninë e palëve.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë

12. Kolegji mori në shqyrtim pretendimin e subjektit të rivlerësimit se: *konkluzioni i Komisionit që ajo dhe personat e lidhur gjenden në mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e gjendjes së likuiditeteve cash, në shumën 4.000 euro, të deklaruar në deklaratën e pasurisë vetting, është i padrejtë dhe i gabuar për shkak se në analizën financiare nuk janë përfshirë: (i) të ardhurat e siguruara nga shitja e automjetit⁵ në vitin 2013, i cili ishte fituar nëpërmjet dhurimit nga bashkëshorti; (ii) të ardhurat e siguruara nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz”⁶, në vitin 2016; duke analizuar si vijon.*

12.1. Komisioni rezulton të ketë kontrolluar burimet e krijimit të pasurisë likuiditet në vlerën prej 4000 eurosh, të deklaruar në gjendje *cash* në banesë, në deklaratën e pasurisë *vetting*, duke analizuar provueshmërinë dhe ligjshmërinë e të ardhurave të krijuara nga shitja e dy automjeteve në pronësi të subjektit e personit të lidhur, të cilat janë deklaruar se kanë shërbyer si burim për krijimin e kësaj pasurie. Në përfundim të kontrollit të ushtruar lidhur me to, Komisioni ka konkluduar se:

Trupi gjyqësor vlerëson se subjekti i rivlerësimit shpjegoi bindshëm dhe paraqiti dokumentacion provues në lidhje me dhurimin e këtij automjeti nga ambasada belge në Athinë. Për këtë arsye,

⁵ Ky automjet është përfituar nga bashkëshorti i subjektit nëpërmjet dhurimit nga Konsullata e Mbretërisë së Belgjikës në Athinë më datë 19.11.2013 dhe me anë të kontratës së shitjes nr. {***}, datë 19.11.2013, është shitur në vlerën 2.500 euro.

⁶ Ky automjet është blerë me anë të kontratës nr. {***}, datë 15.11.2011, në vlerën 300.000 lekë, dhe është shitur me kontratën e nr. {***}, datë 5.12.2016, në vlerën 3.100 euro.

Komisioni ka marrë në konsideratë dhurimin e këtij automjeti sipas deklaramit të subjektit dhe paraqiti në analizën financiare vetëm shpenzimet e kryera për zhdoganimin e këtij automjeti, në shumën 62.834 lekë. Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga shitja e këtij automjeti në shumën 2.500 euro, në konsideratë të provës së dërguar nga subjekti se i janë dhuruar, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit ka realizuar fitim nga shitja e këtij automjeti dhe në vlerësim të parashikimeve të germës “g” të pikës 1 të nenit 8 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, i cili përcakton se: “Për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale, merren si të ardhura të tatueshme të ardhura të tjera që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen, të realizuara nga individë rezidentë ose nga persona jorezidentë, por me burim në Republikën e Shqipërisë”. Referuar këtij neni, të ardhurat e realizuara nga shitja me fitim e pasurive të luajtshme nuk bëjnë pjesë në të ardhurat e përjashtuara nga neni 8/1 i të njëjtit ligj. Për vlerën e fitimit të realizuar nga shitja e këtij automjeti, konkretisht për shumën 287.766 lekë (si diferencë midis të ardhurave nga shitja në vlerën 350.600 lekë me shumën e shpenzimeve doganore në vlerën 62.834 lekë), nuk u provua pagimi i detyrimit tatimor mbi këtë fitim. Për rrjedhojë, vlera e fitimit të realizuar në shumën 287.766 lekë, rezulton të jetë e ardhur e paligjshme, në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 30 të ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë mungesë financiare në shumën 408.963 lekë³⁵ nga burime të ligjshme të të ardhurave nga shitja e dy automjeteve, për të kursyer likuiditete cash në shumën 4.000 euro, të deklaruara në deklaratën e pasurisë vetting. Si përfundim, Komisioni konkludon se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e gjendjes së likuiditeteve cash në shumën 4.000 euro, duke u gjendur brenda parashikimeve të germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

12.2. Në ankim, subjekti i rivlerësimit, znj. Gentiana Xhelili, pretendon se Komisioni me të padrejtë nuk ka konsideruar si të ardhur vlerën e plotë të siguruar nga shitja e automjetit të dhuruar bashkëshortit të saj, ambasadori i Mbretërisë së Belgjikës në Athinë. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti parashtron se në kushtet kur nuk ka dyshime mbi dhurimin e këtij automjeti, i cili është i provuar me dokumentacion të kohës kur ka ndodhur dhurimi, si dhe nuk ka dyshime mbi mundësinë e dhuruesit (ambasadori i Mbretërisë së Belgjikës në Athinë M.V.D.R), për të financuar me burime të ligjshme blerjen e automjetit të dhuruar, është e paarsyeshme dhe jo e bazuar ligjërisht moskonsiderimi i shumës së përfitur nga shitja e këtij automjeti prej bashkëshortit të subjektit, si e ardhur e ligjshme. Subjekti nënvizon se edhe në versionin sipas të cilit duhet të përcaktohet vlera e së ardhurës që duhet t’i nënshtrohet tatimit, ajo duhet të përcaktohet si rezultat i zbritjes së vlerës së shitjes dhe asaj që rezulton se ka pasur automjeti në kohën e dhurimit të tij, përfshi vlerën e zhdoganimit. Kjo vlerë do të duhej të dilte nga diferenca midis vlerës së shitjes së automjetit prej 2.500 eurosh, ekuivalent me 350.600 lekë - 362.834 lekë, që përfaqëson vlerën e automjetit në kohën e dhurimit, dhe rezultati do të tregonte se subjekti nuk kishte realizuar fitim nga shitja e automjetit.

12.3. Kolegji mori në shqyrtim këtë pretendim të subjektit duke konstatuar fillimisht disa rrethana të situatës faktike, të cilat ndikojnë në kontrollin e qëndrimit ligjor të mbajtur prej Komisionit. *Së pari*, rezulton se automjeti tip “Mercedes-Benz” është pranuar se i është dhuruar bashkëshortit të subjektit prej Ambasadori të Mbretërisë së Belgjikës në Athinë, në vitin 2013,

fakt të cilin e ka pranuar dhe konfirmuar edhe Komisioni në vendimin e tij. Për të mundësuar qarkullimin e tij në territorin shqiptar, në mënyrë të ligjshme, bashkëshorti i subjektit ka paguar detyrimin doganor, në vlerën prej 62.834 lekësh, shpenzim i cili, konsideruar edhe vlerën e automjetit në momentin e futjes në territorin shqiptar, mbi të cilin është përcaktuar taksa doganore, është njohur nga Komisioni si i zbritshëm në raport me çmimin e shitjes së këtij automjeti, në vlerën prej 2500 eurosh. Mbi këto rrethana, Komisioni ka kalkuluar se vlera e përfituar prej subjektit dhe personit të lidhur si e ardhur prej këtij transaksioni, është diferenca mes çmimit të shitjes së automjetit dhe vlerës së shpenzuar për taksën doganore, vlerë e cila përkon me vlerën e automjetit të dhuruar, dhe e cila duhej t'i nënshtrohej pagimit të detyrimeve tatimore. Kolegji vëren se Komisioni ka konsideruar si të ardhur të krijuar rishtas vlerën e shitjes së automjetit të përfituar nga dhurimi. Sipas vlerësimit të Kolegjit, kjo vlerë e përfituar me dhurim, është krijuar si e ardhur në momentin e dhurimit të automjetit, moment në të cilin subjekti përfitues nuk rezulton të jetë ngarkuar me ndonjë detyrim tatimor mbi vlerën që përfaqëson pasuria e luajtshme e dhuruar, edhe në kuptim të parashikimit të nenit 761/1 të Kodit Civil, i cili parashikon se: *Dhurimi është një kontratë me anë të së cilës njëra palë i kalon në pronësi pa shpërblim palës tjetër një send të caktuar ose një të drejtë reale, të cilat kjo i pranon, i ka sjellë atij të drejta pasurore mbi këtë pasuri, pa pasur ndonjë detyrim lidhur me të.* Kolegji ka elaboruar këtë qëndrim në jurisprudencën e tij, të cilën e gjejmë të pasqyruar në disa vendime të tij⁷. Në vijim, Kolegji konstaton se vlera e shitjes së automjetit në vitin 2013, për 2500 euro, ekuivalente me 350.600 lekë, është më e ulët se vlera e automjetit prej 362.834 lekësh, e përlllogaritur sipas vlerës së tij të pasqyruar në dokumentacionin doganor, mbi të cilën është përlllogaritur edhe taksa doganore (287.766 lekë + 62.834 lekë). Në këto kushte, duke qenë se në total, vlera e krijuar prej shitjes së këtij automjeti është më e ulët se vlera që ka përfaqësuar automjeti në momentin e fitimit të pronësisë mbi të, nuk rezulton që subjekti apo personi i lidhur të kenë krijuar fitim/të ardhura shtesë të cilat do të duhej t'i nënshtroheshin pagimit të detyrimeve tatimore.

12.4. Lidhur me automjetin tip “Mercedes Benz”, të shitur në vitin 2016, sipas akteve në fashikullin e hetimit administrativ, rezulton të jetë blerë me anë të kontratës nr. {***}, datë 15.11.2011, në vlerën 300.000 lekë dhe të jetë është shitur me kontratën e nr. {***}, datë 5.12.2016, në vlerë 3.100⁸ euro (ekuivalent me 421.197 lekë). Komisioni edhe për këtë pasuri nuk ka njohur si të ligjshme të ardhurat e krijuara si diferencë e çmimit të shitjes me atë të blerjes prej 121.197 lekësh, për shkak se nuk është provuar pagesa e detyrimeve tatimore për këtë të ardhur të krijuar nga ky transaksion.

⁷ Në vendimin e Kolegjit nr. 15/2020 (JR), Kolegji lidhur me dhurimin ka arsyetuar:

“Neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 parashikon vetëm detyrimin e subjektit dhe personit tjetër të lidhur për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë prej personit tjetër të lidhur. Në këtë kuptim, verifikimi i ligjshmërisë së krijimit duhet të ndalet deri te burimi i krijimit të saj, që është mënyra se si personi tjetër i lidhur e ka krijuar atë. Referuar përmbajtjes së dispozitës së cituar, subjekti nuk është individ që e ka krijuar këtë pasuri, por atë e ka përfituar bashkëshortja e tij nëpërmjet dhurimit që, sipas përkufizimit të nenit 761/1 të Kodit Civil: *Dhurimi është një kontratë me anë të së cilës njëra palë i kalon në pronësi pa shpërblim palës tjetër një send të caktuar ose një të drejtë reale, të cilat kjo i pranon, i ka sjellë atij të drejta pasurore mbi këtë pasuri, pa pasur ndonjë detyrim lidhur me të.* Për pasojë, në këtë kuptim, subjekti është i zhveshur në kuptim të këtij ligji nga ndonjë detyrim i cili do të kondiciononte ligjshmërinë e pasurisë përtej provimit të krijimit të saj prej personit të lidhur nga burime të ligjshme e të verifikueshme”.

⁸ Shuma e shitjes prej 3.100 eurosh, është konvertuar me kursin e këmbimit 1 euro = 135,87 lekë.

12.5. Kolegji vlerësoi këtë qëndrim të Komisionit në konsideratë të legjislacionit të zbatueshëm, sipas të cilit nuk evidentohet/përcaktohet shprehimisht detyrimi për pagimin e tatimit mbi diferencën që vjen nga çmimi i shitjes me atë të blerjes së një pasurie të luajtshme. Gjithashtu sille të vëmendje se sipas dispozitave kushtetuese dhe interpretimit që u është bërë atyre nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese⁹, përcaktimi i të ardhurave “të tatueshme” nuk është lënë në diskrecion të organeve ligjzbatuese”, por i është njohur vetëm ligjit, pasi neni 155 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë sanksionon se taksat, tatimet dhe detyrimet financiare kombëtare e vendore, lehtësimi ose përjashtimi prej tyre i kategorive të caktuara të pagesve, si dhe mënyra e mbledhjes së tyre caktohen me ligj. Për këto arsye, trupi gjykues vlerësoi se ndryshimi që ka pësuar ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, me miratimin e ligjit nr. 9161, datë 18.12.2003¹⁰, sipas të cilit, në nenin 8 të tij që përcakton të ardhurat e tatueshme, u shtua një paragraf me përmbajtje: *g) të ardhura të tjera, që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen, të realizuara nga individë rezidentë ose nga persona jorezidentë, por me burim në Republikën e Shqipërisë* – nuk duhet t’i nënshtrohet një interpretimi të zgjeruar, me rezultat përcaktimin e detyrimit për pagesën e tatimit për të ardhurat e krijuara, si pasojë e transaksioneve të shitblerjeve të automjeteve në kushtet e paqartësisë lidhur me shkallën tatimore, bazën e tatueshme, mënyrën e pagesës dhe agjentin tatimmbledhës. Përveç sa më sipër, Kolegji mori në konsideratë edhe qëndrimin e mbajtur nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, lidhur me përcaktueshmërinë e këtij detyrimi të pasqyruar në shkresën nr. {***} prot., të datës 25.05.2023, përcjellë në përgjigje të kërkesës së Kolegjit për informacion. Në këtë dokument, pasqyrohet qëndrimi i këtij institucioni se, për qëllim të tatimit të të ardhurave personale, neni 8 i ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe udhëzimi i Ministrisë së Financave, i miratuar në zbatim të tij nr. 5, datë 30.01.2006, i ndryshuar, nuk ka të përfshirë dhe/ose cituar si të ardhura të tatueshme, të ardhurat nga shitja e pasurisë së luajtshme (automjet për përdorim personal). Mbështetur në arsyetimin e bërë më sipër, Kolegji vlerësoi të konsiderojë të ligjshme të ardhurat e krijuara prej shitjes edhe të këtij automjeti, sa kohë që Komisioni nuk ka ngritur dyshime mbi fiktivitetin e çmimit të blerjes apo shitjes së tij.

12.6. Për sa më sipër, në ndryshim nga Komisioni, duke konsideruar si të ligjshme të ardhurat e krijuara nga shitja e dy automjeteve të analizuara më lart, Kolegji konstaton se subjekti arrin të justifikojë me burime të ligjshme shumën prej 4000 eurosh, të deklaruar gjendje *cash* e të krijuar me burim të ardhurat e përfituara nga shitja e këtyre pasurive.

12.7. Në përfundim, lidhur me këtë shkak ankimi për pasurinë likuiditet në shumën prej 4.000 eurosh, të deklaruar si gjendje *cash* në deklaratën e pasurisë *vetting*, Kolegji konkludoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur justifikojnë krijimin e saj me të ardhura të ligjshme, sipas përcaktimit të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19 e ligjit

⁹ Në vendimin nr. 16, datë 25.07.2008, të Gjykatës Kushtetuese, është arsyetuar se: “Marrëdhëniet e tatim-taksave janë marrëdhënie ligjore detyrimi ndërmjet shtetit dhe tatimpaguesve dhe si të tilla ato mund të përcaktohen vetëm me ligj”. Shih : https://www.gjk.gov.al/web/Vendime_perfundimtare_100_1.php

¹⁰ Ligji nr. 9161, datë 18.12.2003, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

nr. 84/2016. Të ardhurat e krijuara nga shitja e dy automjeteve: “Mercedes-Benz”, me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 5.12.2016, në vlerën prej 3.100 eurosh, si dhe të automjetit “Mercedes-Benz”, me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.11.2013, në vlerën prej 2.500 eurosh, të cilat kanë shërbyer për krijimin e kësaj shume, u konsideruan prej Kolegjit si të ardhura të ligjshme, të cilat nuk i nënshtrohen pagimit të detyrimeve tatimore sipas parashikimeve ligjore në fuqi dhe, për pasojë, burimi i krijimit të kësaj pasurie është i justifikueshëm ligjërisht.

13. Kolegji mori në shqyrtim pretendimin e subjektit të rivlerësimit, me të cilin ai kundërshton si jo të drejtë dhe të bazuar në ligj konkluzionin e Komisionit lidhur me pasurinë likuiditet, të ndodhur në llogarinë bankare në emër të bashkëshortit, në Raiffeisen Bank, në vlerën 133.168,87 lekë, për të cilën ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e të ardhurave nga qiraja e apartamentit në pronësi të prindërve të bashkëshortit, në shumën prej 1.470.000 lekësh, të ardhura që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie, si edhe për blerjen e kuotave në fondin e investimit Raiffeisen Prestigj. Për këto të ardhura, subjekti i rivlerësimit pretendon se: (i) ato janë krijuar nga burime të ligjshme, në kuptimin që ligji “Për tatimin mbi të ardhurat” jep për to; (ii) për këto të ardhura janë paguar detyrimet tatimore dhe se neni D i Aneksit të Kushtetutës nuk e lidh pagesën e tatimeve me një afat të caktuar; (iii) detyrimi për pagimin e tatimeve për të ardhurat nga qiradhënia e apartamentit nuk ka qenë i subjektit, por i prindërve të bashkëshortit, të cilët, sipas ligjit nr. 9049, datë 10.03.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, nuk kishin detyrimin për deklarim dhe se ata konsiderohen si persona të lidhur vetëm me ligjin e ri nr. 84/2016.

13.1. Në vendimin e Komisionit lidhur me të ardhurat e siguruara nga dhënia me qira e apartamentit në pronësi të prindërve të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, është konkluduar sa vijon:

Në konkluzion, të ardhurat e përfituara nga qiraja e apartamentit, pavarësisht bindjes së trupit gjykues se ato kanë ardhur nga qiraja, nuk konsiderohen të ardhura të ligjshme për efekt të procesit të rivlerësimit, për shkak se nuk kalojnë testin e pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Si përfundim, Komisioni konkludon se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e të ardhurave nga qiraja e apartamentit, në shumën 1.470.000 lekë, në pronësi të prindërve të bashkëshortit, të ardhura që kanë shërbyer si burim për krijimin e blerjes së kuotave në fondin e investimit Raiffeisen Prestigj, duke u gjendur brenda parashikimeve të germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

13.2. Nga analizimi i akteve të administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, Kolegji konstaton se, për të ardhurat e siguruara nga qiraja e apartamentit në pronësi të prindërve të bashkëshortit të saj, rezultojnë të provuara faktet si më poshtë:

- *Në deklaratën e pasurisë vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursime nga paga dhe qiraja e apartamentit në pronësi të prindërve të bashkëshortit M. dhe S. Rr., gjendur në llogarinë bankare nr. {***}, në “Raiffeisen Bank”, në emër të bashkëshortit, në vlerën*

133.168,87 lekë. Pjesa takuese 50%. Si burim krijimi të kursimeve, subjekti ka deklaruar kursimet nga paga dhe qiraja e apartamentit në pronësi të prindërve të bashkëshortit.

- Në deklaratën e pasurisë vetting, subjekti i rivlerësimit gjithashtu ka deklaruar të ardhura nga qiraja e apartamentit të ndodhur rrugën “{***}”, pallati nr. {***}, shk. {***}, kati {***}, ap. {***}, Tiranë, në pronësi të prindërve të bashkëshortit M. dhe S. Rr., me të dhënat vijuese: (i) shumën 196.500 lekë, për periudhën 8.10.2010 - 8.12.2011, me qiramarrës E. Gj. dhe B. Gj.. Vlera e qirasë ka kaluar në numrin e llogarisë së subjektit; (ii) shumën 230.000 lekë, për periudhën 15.12.2011 – 23.10.2012, me qiramarrës J. F., sipas kontratës së qirasë nr.{***}, datë 15.12.2011. Vlera e qirasë ka kaluar në numrin e llogarisë së bashkëshortit A. Rr.; (iii) shumën 1.043.500 lekë, për periudhën mars 2013 dhe në vijim, sipas kontratës së qirasë nr. {***}, datë 24.1.2017, me qiramarrës A. B. Sh.. Vlera e qirasë ka kaluar në numrin e llogarisë së bashkëshortit A. Rr..
- Në DPV-në e vitit 2010, subjekti i rivlerësimit deklaroi të ardhura nga qiraja në vlerën 22.000 lekë/muaj, për periudhën 8.10.2010 – 31.12.2010.
- Në DPV-në e vitit 2011, subjekti i rivlerësimit deklaroi kontratën e qirasë së lidhur për periudhën 8.10.2010 – 8.12.2011, me vlerë 22.000 lekë/muaj.
- Në DPV-në e vitit 2012, vjehri i subjektit të rivlerësimit, z. M. Rr., deklaroi dhënien e apartamentit me qira, z. J. F., në vlerë 23.000 lekë/muaj, kontrata lidhur më 15.12.2011.
- Në DPV-në e vitit 2013, vjehri i subjektit të rivlerësimit M. Rr., deklaroi dhënien e apartamentit me qira z. A. Sh., në vlerë 22.000 lekë/muaj kontrata lidhur më 15.12.2011.
- Në DPV-në e vitit 2014, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit A. Rr., deklaroi të ardhura nga qiraja me qiramarrësin A. Sh. në total në vlerën 264.000 lekë.
- Në DPV-në e vitit 2015, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit A. Rr., deklaroi të ardhura nga qiraja me qiramarrësin A. Sh., në total në vlerën 147.500 lekë.

13.3. Gjatë procesit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e dhëna për pyetëtorin standard (nr. 1), ka deklaruar se për të ardhurat e realizuara nga qiraja, tatimi në burim është paguar sipas llogaritjes së kryer nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë¹¹. Në cilësinë e provës, subjekti ka paraqitur shkresën nr. {***} prot., datë 28. 1.2019, lëshuar nga Drejtoria e Tatimeve Vlorë, ku rezulton se shtetasi M. Rr. (vjehri), është i regjistruar për përgjegjësinë tatimore të tatimit të mbajtur në burim dhe ka paguar tatimin mbi qiranë në vlerën 362.850¹² lekë, si dhe nuk ka detyrime të papaguara deri në datën 28.01.2020.

13.4. Komisioni, pavarësisht se i ka konsideruar këto të ardhura, si të krijuara nga një burim i ligjshëm, ka vlerësuar se ato nuk përmbushin standardin kushtetues dhe ligjor të së ardhurës së

¹¹ Shkresa nr. {***} prot., datë 18.03.2021, nga e cila rezulton se detyrimi tatimor është përlllogaritur nga inspektorët e Drejtorisë Tatimore Vlorë në bazë të dokumentacionit (statement bankar dhe kontrata qiraje) të depozituara me kërkesën nr. {***} prot., datë 17.01.2020, si dhe ligjit nr. 8438/1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

¹² Shkresa nr. {***}, datë 30.12.2020 dhe shkresa nr. {***} prot., datë 23.12.2020, në të cilat rezulton se M. Rr. është objekt i deklaramit individual të tatimit në burim mbi të ardhurat, i cili ka deklaruar në muajin 12/2019 dhe ka dorëzuar deklaratën më datë 28.01.2020 dhe likuiduar në datë **30.01.2020**. M. Rr. ka deklaruar të ardhura nga qiraja në shumën 3.122.500 lekë dhe ka paguar tatimin e mbajtur në burim në vlerën 362.850 lekë. Në këtë vlerë janë përfshirë të ardhurat nga qiraja në shumën 1.931.875 lekë për periudhën 2010-2018 dhe të ardhurat nga qiraja e tokës bujqësore në shumën totale (për vitet 2011-2014) 1.200.000 lekë. Vlera totale 3.131.875 lekë.

ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, meqenëse nuk janë paguar detyrimet tatimore në kohën e krijimit të tyre. Sipas këtij qëndrimi, që një e ardhur të konsiderohet si e ardhur e ligjshme sipas dispozitave të mësipërme, kërkohet të plotësohen në mënyrë kumulative elementet që dëshmojnë gjurmë të përfitimit të saj në kohën e krijimit, se është e ardhur e siguruar nga burime të ligjshme (*nga ato të parashikuara nga legjislacioni për tatimin mbi të ardhurat*) dhe se janë paguar detyrimet tatimore për të.

13.5. Kolegji konstaton se referuar të dhënave të përshkruara më sipër, rezulton se për të ardhurat nga qiraja e apartamentit të prindërve të bashkëshortit të subjektit në Tiranë, detyrimet tatimore janë paguar me vonesë dhe jo në mënyrë të përvitshme, në vitin kur ato janë realizuar. Pagimi me vonesë i tatimeve për të ardhurat nga qiraja, sipas subjektit të rivlerësimit, duhet vlerësuar duke konsideruar që ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar nuk e lidh pagesën e tatimeve me një afat të caktuar, si dhe duhet konsideruar se detyrimi për pagimin e tatimit nuk ka qenë i subjektit të rivlerësimit, por i prindërve të bashkëshortit, të cilët vetëm sipas ligjit nr. 84/2016, për shkak të të qenit në të njëjtën gjendje familjare me subjektin e rivlerësimit në regjistrat e gjendjes civile, kanë marrë cilësinë e personave të lidhur.

13.6. Kolegji, në vlerësim të situatës së mësipërme, mori fillimisht në analizë pretendimin e subjektit të rivlerësimit se ato janë krijuar nga burime të ligjshme në kuptimin që ligji “Për tatimin mbi të ardhurat” jep për to dhe konstatoi se të ardhurat e përfituara prej dhënies me qira të apartamentit të ndodhur në Tiranë, në pronësi të prindërve të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, janë deklaruar prej subjektit, bashkëshortit të saj dhe babait të këtij të fundit, në deklaratat periodike vjetore 2010 deri 2015, si të ardhura të përfituara prej kësaj marrëdhënieje, duke përcaktuar në to shumën konkrete të përfituar, në total prej 1.400.000 lekësh. Pavarësisht se deklarues në këto deklarata figurojnë subjekti dhe personat e lidhur, marrëdhënia juridike që i ka siguruar të ardhurat dhe shuma respektive janë përshkruar saktësisht në këto deklarata, të cilat, sipas parashikimit të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, kanë vlerën e provës në këtë proces. Këto deklarime të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të në deklaratat periodike, janë të njëjta edhe më deklarimet e bëra në deklaratën e pasurisë *vetting*. Përpos sa deklaruar prej subjektit, rezulton se në llogarinë bankare të subjektit të rivlerësimit me nr. {***} në Raiffeisen Bank dhe të bashkëshortit, me nr. {***} në Raiffeisen Bank, është derdhur në vitet 2010 deri në vitin 2015 në mënyrë periodike, e gjithë shuma e pretenduar prej kësaj marrëdhënieje nga shtetasit e deklaruar si qiramarrës¹³. Në këtë kontekst, Kolegji vëren se, ashtu si edhe Komisioni se provohet bindshëm se burim i shumës prej 1.400.000 lekësh, të kredituar në llogaritë bankare të subjektit dhe personit të lidhur në vitet 2010-2014, është marrëdhënia e qirasë për apartamentin e ndodhur në Tiranë, në pronësi të prindërve të bashkëshortit të subjektit. Në këtë kuptim, Kolegji çmon se plotësohet edhe një nga kushtet e

¹³ *Emrat e qiramarrësve: E. G., depozituar shumat në llogari të subjektit të rivlerësimit; B. G., J. F., A. Sh., depozituar shumat në llogari të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.*

përcaktuara prej Kolegjit në vendimin e tij nr. 15/2021(JR)^{14,15} në të cilin jepen orientimi mbi vlerësimin e pagimit me vonesë të detyrimeve tatimore që kanë pasur subjektet. Sipas këtij orientimi, kushti i parë mbi të cilin do të duhej të bëhej ky vlerësim, është provueshmëria e burimit të krijimit të të ardhurave, provueshmëri e cila në rastin në fjalë, konsiderohet e plotë edhe prej kësaj trupe gjyquese.

13.7. Duke superuar si të provuar këtë rrethanë të qëndrimit orientues, Kolegji mori në shqyrtim rrethanat e faktit që përcaktonin kushtet e tjera sipas këtij qëndrimi, ato që lidhen me sjelljen e subjektit në raport me mospagimin e detyrimeve tatimore, në raport me përcaktimin nëse ajo ka qenë në mirëbesim apo keqbesim në drejtim të kohës së pagimit të këtyre detyrimeve.

13.8. Në analizë të rrethanave të faktit, rezulton se të ardhurat e përfituara nga qiraja, përveç se janë derdhur periodikisht në llogaritë bankare të subjektit dhe bashkëshortit, janë përfitur nga kontrata e qirasë të lidhura, me shkresë por edhe verbalisht, nga prindërit e bashkëshortit të subjektit me qiramarrësit, duke qenë se ata ishin pronarët e pasurisë së paluajtshme të dhënë me qira. Në këtë kuptim, nuk rezulton një përgjegjësi e drejtpërdrejtë e subjektit të rivlerësimit, znj. Gentiana Xhelili, për t'u kujdesur për pagimin e detyrimeve që rrjedhin nga kjo marrëdhënie, duke qenë se ajo vetë apo bashkëshorti i saj nuk ishin palë në këtë marrëdhënie. Të njëjtin kujdes të shtuar nuk duket se e kishin edhe prindërit e bashkëshortit për periudhën 2010-2015, pasi ata nuk ishin persona të lidhur të subjektit dhe, si të tillë, nuk mbartnin detyrimin për deklarim të pasurive, me të cilin u ngarkuan vetëm pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, meqenëse prindërit e bashkëshortit ishin në një certifikatë familjare me subjektin përgjatë periudhës së rivlerësimit. Rezulton gjithashtu nga shkresa e DRTP-së¹⁶ se babai i bashkëshortit ka paguar detyrimet tatimore për këto të ardhura në datën 30.01.2020 [në masën 15% të të ardhurave, nga 10% që ka qenë në kohën e përfitimit të tyre], duke plotësuar në këtë mënyrë edhe kushtin e parashikuar nga neni 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016 për ligjshmërinë e së ardhurës. Në këto rrethana, fakti i përfitimit të së ardhurës prej një kontrate qiraje si një burim i ligjshëm, i deklaruar saktësisht në DPV-të respektive, nëpërmjet sistemit bankar, si

¹⁴ Qëndrim orientues, i cili rezulton të jetë arsyetuar në shtator të vitit 2021, pra si i tillë daton pas dhënies së vendimit të Komisionit për subjektin e rivlerësimit, znj. Gentiana Xhelili, i cili mban datën 24.04.2021. Për këtë arsye, subjekti pretendimin për të trajtuar çështjen e tatimit me vonesë për të ardhurat e qirasë së apartamentit të vjehrrit dhe vjehrrës e ka ngritur në parashtrimet që ka sjellë në Kolegj para seancës gjyqësore në dhomë këshillimi të datës 03.07.2023.

¹⁵ Për sa i përket një qëndrimi orientues, në referim të nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në lidhje me pagesat me vonesë të detyrimeve tatimore, nëse ato do të mundësojnë legjitimitimin e të ardhurave të krijuara, Kolegji çmon se vlerësimi i tyre do të duhet të bëhet duke konsideruar disa rrethana. Së pari, duhet që të provohet bindshëm vetë ekzistenca e të ardhurave në kohën e krijimit të tyre, pasi pagimi i detyrimit tatimor nuk mund të shërbejë si një mjet për të provuar krijimin e të ardhurave që nuk provohen me mjete të tjera. Së dyti, në konsideratë të organeve të rivlerësimit duhet të mbahet sjellja e subjektit apo e personave të lidhur dhe e personave të tjerë të lidhur në raport me mospagimin në kohë të tyre. Brenda këtij kriteri, do të duhet të vlerësohen rrethanat që kanë shkaktuar mospagimin në kohë të detyrimit për të përcaktuar nëse mospagimi ka qenë pasojë e ndonjë pakujdesie apo paqartësie apo një qëllim për t'u arritur. Në çdo rast, këto të ardhura nuk mund të legjitimohen nëse subjektet, personat e lidhur apo personat e tjerë të lidhur kanë qenë në kushte keqbesimi, në kufijtë e kryerjes së një vepr penale [...].

¹⁶ Shkresa nr. {***}, datë 30.12.2020 dhe shkresa nr. {***} prot., datë 23.12.2020.

edhe pagimi me vonesë i detyrimeve tatimore nga personi përgjegjës sipas ligjit, vjehri i subjektit, u vlerësuar nga Kolegji si rrethana që e përlligjin krijimin e kësaj të ardhure dhe përjashtuan çdo dyshim mbi ekzistencën dhe ligjshmërinë e saj.

13.9. Në këto kushte, Kolegji, pasi mori në analizë ligjshmërinë e të ardhurave të krijuara nga marrëdhënia e qirasë së apartamentit të vjehrit dhe vjehrrës së subjektit, të ndodhur në rrugën “{***}” në Tiranë, në shumën totale prej 1.470.000 lekësh, të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe deklaratimet periodike në vitet 2010-2016, të transferuara në llogaritë bankare të subjektit e bashkëshortit të saj dhe konkludoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur arritën të provonin se këto të ardhura ishin krijuar nga një burim i ligjshëm i parashikuar prej nenit 4 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, dhe se pagimi me vonesë i detyrimeve tatimore lidhur me këto të ardhura, i kryer nga vjehri i subjektit të rivlerësimit, kalon testin e qëndrimit orientues të Kolegjit të dhënë në vendimin nr. 15/2021 (JR) e, për pasojë, plotësojnë kërkesat e ligjit për t’u konsideruar si të ardhura të ligjshme në kuadër të këtij procesi.

- 14.** Kolegji mori në shqyrtim pretendimin e subjektit të rivlerësimit që kundërshton *si jo të drejtë dhe të bazuar në ligj e në situatën faktike konkluzionin e Komisionit se nuk ka deklaruar saktë gjendjen cash prej 900.000 lekësh në deklaratën e pasurisë vetting të vitit 2017, dhe se ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e të ardhurave nga qiraja e tokës bujqësore, në vlerën 1.200.000 lekë, të ardhura që kanë shërbyer si burim për krijimin e kësaj gjendjeje cash dhe për blerjen e kuotave në fondin e investimit Raiffeisen Prestigj.*

14.1. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar fillimisht se nuk është i drejtë dhe i bazuar ligjërisht konsiderimi nga Komisioni si deklarim i pasaktë, në kundërshtim me nenin 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, e deklarimeve që janë kryer në deklaratat periodike të pasurive. Lidhur me këtë shkak, Kolegji konstaton dhe analizon sa vijon.

14.2. Lidhur me këtë çështje, Kolegji konstaton se Komisioni, pasi ka analizuar deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike të viteve kur ai ka deklaruar krijimin e kursimeve të gjendjes *cash*, ka konstatuar se ai dhe personi i lidhur kanë deklaruar në mënyrë të pasaktë këtë gjendje dhe kanë krijuar konfuzion në përlllogaritjen e gjendjes *cash* në fund të periudhës së rivlerësimit, por edhe të gjendjes *cash* progresive sipas analizës së Komisionit. Në këto pasaktësi është përfshirë edhe deklarimi i gjendjes së *cash*-it sipas monedhës lekë, duke konfunduar konceptin e lekëve “të rinj” me ata “të vjetër”. Pavarësisht këtyre deklarimeve, Komisioni pasi ka shtruar pyetje dhe ka marrë përgjigje prej subjektit ka përlllogaritur gjendjen e *cash*-it, sipas një analize harmonike të deklarimeve të subjektit në vite, shpjegimeve në hetimin administrativ, si edhe përlllogaritjeve të bëra nga Komisioni për mundësinë e krijimit të gjendjes *cash* përgjatë periudhës së rivlerësimit¹⁷. Në përfundim,

¹⁷ Në përfundim të analizimit të këtij deklarimi, Komisioni çmon se në rastin konkret, duhen marrë në konsideratë në analizën financiare shpjegimet e subjektit lidhur me kursimet e viteve 2014 dhe 2015, pra, respektivisht shumë 700.000 lekë për vitin 2014 dhe 800.000 lekë për vitin 2015, kjo për shkak të ndërthurjes së elementeve të analizës së deklarimeve të subjektit, shpjegimeve të tij, si dhe një vlerësimi logjik e të arsyeshëm të të gjitha rrethanave të renditura në vijim: (i) nëse ndjekim logjikën e deklarimeve të subjektit, gjendja nënkupton shtimin dhe pakësimin pasurisë, konfirmuar kjo edhe nga deklarimi në rubrikën “shtesa dhe pakësime”. Në rast se në përlllogaritjen e

Komisioni ka arritur në konkluzionin *se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë në deklaratat periodike vjetore 2014 dhe 2015, duke u gjendur në kushtet e germës “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.*

14.3. Në ankim subjekti e kundërshton këtë qëndrim të Komisionit duke sjellë në vëmendje se objekt kontrolli në funksion të procesit të rivlerësimit, i cili e ngarkon subjektin me përgjegjësi, janë deklaramet e bëra në deklaratën e pasurisë *vetting*. Kolegji, lidhur me mënyrën e deklaramit të kursimeve *cash* në deklaramet periodike vjetore, konstaton se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaramet për kursime në *cash* përkatësisht në vitet 2008-2016. Nga analizimi i këtyre DVP-ve, Komisioni, për sa i përket saktësisë së deklarameve, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendjen e likuiditeteve *cash* duke përdorur konceptin e lekëve “të vjetër” në vitet 2014 dhe 2015¹⁸. Në të tilla kushte, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit në pyetësorin nr. 2, të saktësojë gjendjen *cash*-it të shtuar në fund të çdo viti. Në përgjigje të kësaj kërkesë, subjekti ka plotësuar një tabelë, tek e cila ka evidentuar kursimet *cash* në fund të çdo viti. Komisioni, pas analizimit të përgjigjeve të dhëna nga subjekti gjatë hetimit administrativ për kursimet në *cash*, rezulton se për efekt të analizës financiare, ka marrë në konsideratë pretendimet e subjektit në lidhje me deklaramin e gjendjes së *cash*-it në fund të viteve 2014 dhe 2015, duke mos konsideruar si shtesa gjendjen e *cash*-it të deklaruar në DVP (me lekë të vjetër), por respektivisht shuma 700.000 lekë shtesë kursimesh në vitin 2014 dhe 800.000 lekë si shtesë kursimesh në *cash* në vitin 2015.

14.4. Kolegji sjell në vëmendje se kjo çështje është elaboruar në jurisprudencën¹⁹ e tij të deritanishme në të cilën, në shumë raste, është mirëspecifikuar se pasaktësitë në deklaramet periodike, të pashoqëruara me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive, nuk mund të konsiderohen si shkaqe që mund të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në kuadër të procesit të rivlerësimit. Për sa më sipër, ky qëndrim i Komisionit që evidenton pasaktësi në deklaramet periodike, të cilat i konsideron jo sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, i cili është miratuar në kohë, pas plotësimit të deklarameve periodike 2014 - 2015, nga Kolegji gjendet jo i drejtë dhe jo i bazuar në ligj dhe nuk mund të shërbejë si një shkak për penalizimin e subjektit të rivlerësimit.

gjendjes progresive të kursimeve cash do të konsiderohej shuma 7.000.000 lekë dhe 8.000.000 lekë, gjendja në datën e plotësimit të deklaratës “vetting” do të ishte 14.900.000 lekë, përkundrejt shumës 900.000 lekë të deklaruar nga subjekti; (ii) shtesat e pretenduara nga subjekti si kursime për vitet 2014 dhe 2015 duket të jenë në trendin e kursimeve të deklaruar në vitet e mëparshme, konkretisht ka deklaruar kursime vlerat 700.000 lekë për vitin 2009; 1.000.000 lekë për vitin 2012; dhe 1.000.000 lekë për vitin 2013; (iii) gjatë viteve 2014 dhe 2015, nuk duket të kenë ndodhur fenomene financiare të tilla që mund të passillnin rritje të fluksit monetar dhe që të mund të kishin një ndikim domethënës në likuiditetet e subjektit, si për shembull shitje e pasurive të paluajtshme, huamarrje, kredi etj.; (iv) në deklaratën periodike të vitit 2009, subjekti ka deklaruar shumën 400.000 lekë dhe, më tej, në kolonën “Vlera dhe shifra me fjalë” deklaruar me shifra 4.000.000 dhe me fjalë “katër milionë lekë”. Po kështu, në të njëjtën deklaratë, subjekti deklaroi të ardhura nga paga 8.070.000 lekë dhe me fjalë “tetë milionë e shtatë mijë lekë të vjetra”. Po kështu, bashkëshorti deklaroi vlerën 300.000 lekë dhe me fjalë “tre milionë lekë të vjetra”, rrethana të cilat tregojnë konfuzion prej subjektit.

¹⁸ Në këto vite, subjekti ka deklaruar në DVP kursime në shumën 7 milionë lekë dhe 8 milionë lekë, me konceptin e lekëve të vjetër.

¹⁹ Shih vendimet e Kolegjit nr. 28/2020 (JR), datë 23.10.2020, që i përket subjektit të rivlerësimit F. V.; nr. 37/2021 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit S. N.; nr. 34/2022 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit A. M..

14.5. Lidhur me të ardhurat e krijuara nga marrëdhënia e qirasë së tokës bujqësore, të analizuar në funksion të verifikimit të mundësisë së subjektit dhe të personave të lidhur për blerjen e kuotave në fondin prestigj të Raiffeisen Bank dhe për të krijuar kursimet në *cash*, në shumën 900.000 lekë, të deklaruara si gjendje në deklaratën e pasurisë *vetting*, Komisioni ka konkluduar se: *Nga hetimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit të vlerësuar nga trupi gjykues, rezultoi se këto të ardhura të përfituara nga qiraja e tokës bujqësore nuk janë deklaruar në organet tatimore dhe nuk është paguar tatimi në burim i këtyre të ardhurave nga personi i lidhur dhe/ose subjekti i rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar dhe paguar tatimin mbi këto të ardhura vetëm në momentin e fillimit të hetimit nga Komisioni. [...] Në këto kushte, Komisioni vlerëson se që të ardhurat e realizuara të kualifikohen si të ardhura të ligjshme, duhet të provohet pagesa e detyrimeve tatimore në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të pikës 19 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, në kohën kur janë përfiturar. Për pasojë, të ardhurat e realizuara nga qiraja e tokës bujqësore nuk do të konsiderohen në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur. Mbështetur në këtë arsytim, Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të ligjshme për blerjen e kuotave në fondin Prestigj të Bankës Raiffeisen, si edhe për krijimin e gjendjes *cash*, deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, prej 900.000 lekësh, duke u gjendur në këtë mënyrë para një deklarimi të pasaktë.*

14.6. Në drejtim të analizimit të këtij shkak, Kolegji konstaton se në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar *kursime cash në vlerën 900.000 lekë, pjesa takuese 50%, me burim krijimi: (a) të ardhura të krijuara nga: (i) paga e subjektit; (ii) paga e bashkëshortit të subjektit; (b) pensionet e prindërve të bashkëshortit; (c) si dhe të ardhura nga dhënia me qira e pasurisë së paluajtshme me natyrë bujqësore, përfiturar nga prindërit e bashkëshortit në të njëjtën përbërje familjare, në bazë të AMTP-së nr. {***}, datë 13.4.1992, në emër të kryefamiljarit M. Rr., me sip. 9.960 m² tokë bujqësore dhe banesë me sip. 110 m², oborr me sip. 250 m² dhe 30 rrënjë ullinj, regjistruar kjo pasuri në regjistrat e ZVRPP-së Fier, vol. {***}, {***}. {***} dhe vol. {***}, {***}. {***}, kontratë qiraje lidhur me marrëveshje të palëve kontraktore me qiramarrës shtetasin N. Sh. Rr. dhe qiradhënës M. Sh. Rr. në datën 1.1.2011, me afat trevjeçar deri më 1.1.2013.*

14.7. Në vijim të analizimit të konkluzionit të vendimit të Komisionit se *subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë gjendjen cash në deklaratën e pasurisë vetting të vitit 2017*, Kolegji vëren se ky qëndrim lidhet me faktin që Komisioni ka përjashtuar nga përlllogaritja në analizën financiare, kursimet e prindërve të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, me të cilët ajo ka jetuar dhe vazhdon të jetojë që prej lidhjes së martesës. Konkretisht, si gjatë hetimit administrativ, ashtu edhe në ankim, subjekti i rivlerësimit, znj. Gentiana Xhelili, ka pretenduar se në momentin e plotësimit të deklaratës së pasurisë *vetting*, e gjithë familja e saj ka disponuar 4000 euro dhe 900.000 lekë. Komisioni, bazuar në të dhënat e deklaratave periodike dhe atyre që kanë rezultuar gjatë hetimit administrativ, ka konkluduar se subjekti ka pasur mundësi për të pasur likuiditete në *cash*, maksimalisht në vlerën prej 4.000 euro dhe në vlerën prej 617.392 lekësh²⁰.

²⁰ 1.600 euro të konvertuara në lekë + 400.000 lekë = 617.392 lekë.

14.8. Sipas pretendimeve të subjektit, kjo diferencë e konstatuar prej Komisionit, vjen për shkak se nuk janë llogaritur si e ardhur, kursimet në *cash* që kanë pasur prindërit e bashkëshortit, në vlerën prej 300.000 lekësh, e cila është krijuar me burim nga shitja e dyqanit në {***} të Fierit (në shumën 1.000.000²¹ lekë), e cila është përdorur pjesërisht gjatë jetesës së përbashkët gjatë periudhës 2006-2016, në varësi të nevojave familjare.

14.9. Në ankim, subjekti i rivlerësimit, znj. Gentiana Xhelili, kërkon nga Kolegji të konsiderojë se në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9049/2003”), ajo, si subjekt deklarues i pasurisë dhe i interesave periodikë, nuk ka pasur detyrim për të deklaruar pasurinë e prindërve të bashkëshortit, edhe pse ata gjendeshin në të njëjtën gjendje familjare me të, duke qenë se detyrimi për deklarimin e pasurive dhe interesave pasurorë, sipas nenit 21 të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, është vetëm për bashkëshortin e subjektit deklarues dhe fëmijët në moshë madhore.

14.10. Nga analiza e deklarimeve periodike të subjektit të rivlerësimit, znj. Gentiana Xhelili, konstatohet se ajo nuk ka deklaruar në këto deklarata lidhur me kursimet në *cash* të prindërve të bashkëshortit të saj. Në analizë të kësaj situate faktike, Kolegji çmon të drejtë qëndrimin e subjektit të rivlerësimit se në zbatim të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, subjekti i rivlerësimit si subjekt deklarues, nuk ka pasur detyrim për deklarimin e pasurive të prindërve të personit të lidhur. Në këtë kuptim, rezulton se vetëm me ligjin nr. 84/2016, në kushtet kur prindërit e bashkëshortit janë në të njëjtën certifikatë familjare me subjektin e rivlerësimit përgjatë periudhës së rivlerësimit, ata konsiderohen persona të lidhur me të dhe, si të tillë, kanë detyrimin për deklarimin e pasurive që ata disponojnë në momentin e plotësimit të kësaj deklarate dhe të burimeve të krijimit të tyre, sipas parashikimit të nenit 3, pika 13 dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016. Bazuar në këtë konstatim, në kushtet kur në rastin objekt shqyrtimi, për prindërit e bashkëshortit të subjektit, mungojnë deklaratimet periodike të cilat janë dokumenti i vetëm nga ku mund të evidentohen kursimet në *cash*, Kolegji konsideron të arsyeshme dhe të drejtë që analiza për familjen e subjektit të bëhet duke përlogaritur mundësinë për kursim të prindërve të personit të lidhur, si para martesë, ashtu edhe pas martesë, deri në fund të vitit 2016, para plotësimit të deklaratës së pasurisë *vetting*, në funksion të përlogaritjes së burimeve të ligjshme për krijimin e gjendjes së *cash*-it prej 900.000 lekësh, të deklaruar në të ²².

14.11. Nga analiza ekonomike e kryer në Kolegji për verifikimin e mundësisë së prindërve të bashkëshortit për të krijuar kursime me burime të ligjshme për periudhën para martesës së subjektit të rivlerësimit, rezulton se në fund të vitit 2008, prindërit kanë pasur mundësi për të disponuar kursime në shumën 1.019.851 lekë²³, me të ardhura kryesisht nga shitja e njësisë

²¹ Prindërit e bashkëshortit kanë nënshkruar një deklaratë noteriale me nr. {***} rep., nr {***} kol., datë 23.03.2021.

²² Shih vendimin nr. 20/2023 (JR), datë 03.05.2023, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit:

https://kpa.al/wpcontent/uploads/2023/10/Vendimi_B._M._perفشire_mendimin_e_pakices_anonimizuar.pdf

²³ Për periudhën 2006-2008, familja e origjinës së bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit ka përfituar të ardhura: a) nga bujqësia në vitin 2006, në shumën 219.114 lekë; në vitin 2007, në shumën 348.144 lekë; b) të ardhura nga paga e bashkëshortit në vitin 2007, në shumën 98.560 lekë; në vitin 2008, në shumën 295.280 lekë; c) në vitin 2006, të ardhura nga shitja e njësisë në shumën 1.400.000 lekë.

(librari) në pronësi të nënës së bashkëshortit, sipas kontratës së shitjes së datës 13.04.2006, në shumën 1.400.000 lekë. Sipas pretendimeve të subjektit, kjo shumë e përfituar dhe e kursyer deri para martese, prej 1.000.000 lekësh, nga shitja e njësisë, është përdorur nga prindërit e bashkëshortit për nevoja familjare, e shpërndarë në vitet 2014-2016, me një total prej 700.000 lekësh. Pjesa e mbetur prej 300.000 lekësh, është pjesë e kursimeve *cash* të disponuara në fillim të vitit 2017, deklaruar nga subjekti në deklaratën e pasurisë *vetting*, e cila ka shërbyer si burim për krijimin e gjendjes së *cash*-it, me përshkrimin “kursime familjare”.

14.12. Përveç sa më sipër, në drejtim të burimeve të cilat kanë shërbyer për krijimin e kursimeve në *cash* të deklaruara në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit, znj. Gentiana Xhelili, si gjatë hetimit administrativ, ashtu edhe në ankim, ka evidentuar se kanë shërbyer edhe të ardhurat e siguruar nga qiradhënia e tokës bujqësore të familjes së origjinës të bashkëshortit të saj, në fshatin {***}, Fier.

14.13. Në vendimin e Komisionit për të ardhurat e siguruar nga qiradhënia e tokës bujqësore të familjes së origjinës së bashkëshortit të saj, ka arsyetuar sa vijon: *Lidhur me pretendimin e subjektit se të ardhurat nga dhënia me qira e tokës bujqësore vijnë nga një burim i ligjshëm, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi dhe provoi bindshëm burimin e krijimit. Subjekti paraqiti vetëm një kontratë të thjeshtë, jonoteriale midis palëve, e cila nuk ishte e besueshme për trupin gjykues, duke pasur parasysh se: (i) kontrata e qirasë ishte me vëllain e babait të bashkëshortit, i cili jetonte në të njëjtin vend ku është edhe prona; (ii) subjekti nuk provoi se xhaxhai i bashkëshortit/qiramarrësi kishte një interes të ligjshëm në marrjen me qira të kësaj pasurie; (iii) subjekti i rivlerësimit i kishte deklaruar si të ardhura të tij me pjesë takuese 100%, në disa DPV vjetore; dhe (iv) pagesa e qirasë ishte bërë cash jashtë sistemit bankar. Nga hetimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit të vlerësuar nga trupi gjykues, rezultoi se këto të ardhura të përfituara nga qiraja e tokës bujqësore nuk janë deklaruar në organet tatimore dhe nuk është paguar tatimi në burim i këtyre të ardhurave nga personi i lidhur dhe/ose subjekti i rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar dhe paguar tatimin mbi këto të ardhura vetëm në momentin e fillimit të hetimit nga Komisioni [...].*

14.14. Në këto kushte, Komisioni nuk i ka njohur dhe përllogaritur këto të ardhura në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit duke konkluduar si pasojë se *subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë gjendjen cash në deklaratën e pasurisë vetting të vitit 2017, në lidhje me këto të ardhura dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e të ardhurave nga qiraja e tokës bujqësore në vlerën 1.200.000 lekë, të ardhura që kanë shërbyer si burim për krijimin e blerjes së kuotave.*

14.15. Nga aktet e hetimit administrativ, lidhur me deklarimin e të ardhurave të përfituara prej qiradhënies së tokës bujqësore të prindërve të bashkëshortit, konstatohet si vijon.

Shpenzimet e jetesës për vitin 2006, në shumën 328.671 lekë; në vitin 2007, në shumën 522.216 lekë; dhe në vitin 2008, në shumën 409.860 lekë. Në datën 31.12.2008, kanë disponuar një llogari bankare në shumën 80.500 lekë. Analiza financiare për këtë periudhë rezultoi me një mundësi kursimi në shumën 1.019.851 lekë.

(i) Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti ka deklaruar të ardhura në vlerën 900.000 lekë nga dhënia me qira e pasurisë tokë bujqësore²⁴.

(ii) Në DVP-2012 dhe DVP-2013, të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, znj. Gentiana Xhelili, në ndryshim nga DVP-të e mëparshme, përveç bashkëshortit të saj, shtojcën e këtyre deklaratave si persona të lidhur e kanë plotësuar edhe vjehri dhe vjehrra e saj, përkatësisht M. R. dhe S. R., në të cilat për tokën bujqësore në {***}, Fier, ata deklarojnë: *Kontratë qiraje e pasurisë së paluajtshme me natyrë bujqësore si më poshtë: Tokë bujqësore me sip. 9960 m², banesë me sipërfaqe 110 m² dhe oborri me sipërfaqe 250 m² dhe 30 rrënjë ullinj, me vlerë 300.000 lekë në vit; pjesa takuese 50%. Kontratë qiraje, datë 01.01.2011. Në DVP-në e vitit 2011, subjekti i rivlerësimit nuk deklaroi të ardhura nga qiraja e tokës bujqësore në {***}, ndërsa bashkëshorti i subjektit ka deklaruar të ardhura nga toka, Fier, në shumën 300.000 lekë në vit. Në DVP-2012 dhe DVP-2013 as subjekti dhe as bashkëshorti nuk deklaroi të ardhura nga qiraje e tokës bujqësore në {***} Fier. Në DVP-në e vitit 2014, subjekti i rivlerësimit deklaroi: *Të ardhura nga kontratë qiraje e pasurisë së paluajtshme me natyrë bujqësore, si më poshtë: Tokë bujqësore me sip. 9960 m², banesë me sipërfaqe 110 m² dhe oborri me sipërfaqe 25 m² dhe 30 rrënjë ullinj, me vlerë 300.000 lekë në vit; pjesa takuese 100%. Kontratë qiraje. Në DVP-në e vitit 2014 e në vijim, deri në DVP-2016, prindërit e bashkëshortit të subjektit, M. R. dhe S. R., nuk deklaroi si persona të lidhur.**

14.16. Si dokumentacion justifikues për të ardhurat e krijuara nga qiradhënia e tokës bujqësore, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një kontratë qiraje të formalizuar sipas një akti të thjeshtë, nënshkruar mes palëve privatisht dhe jo para një noteri publik. Kjo kontratë është nënshkruar ndërmjet qiradhënësit M. Sh. Rr. dhe qiramarrësit N. Sh. Rr., për dhënien me qira të tokës bujqësore me sip. 9.960 m², banesës me sip. 110 m², së bashku me oborrin me sip. 250 m² dhe 30 rrënjë ullinj, të ndodhur në {***}, {***}, Fier. Kontrata është lidhur në datën 01.01.2011, me afat trevjeçar, dhe me të drejtë rinovimi. Sipas përmbajtjes së saj: *Qëllimi i përdorimit të tokës së dhënë më qira do të jetë për kultivim bujqësor; vlera e qirasë është në masën 300.000 lekë/vit dhe në natyrë 100 litra vaj ulliri; pagesa në të holla do të bëhet në çdo datë 20-25 të muajit shtator të çdo viti, ndërsa pagesa në natyrë në muajin janar të çdo viti. Sipas nenit 6 të kontratës, detyrimet tatimore do të mbulohen nga qiradhënësi.*

14.17. Subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, në përgjigjet e dhëna Komisionit në pyetësin standard, ka deklaruar se nga qiraja e tokës bujqësore janë përfituar 1.200.000 lekë, për një periudhë qiradhënieje 4-vjeçare. Subjekti gjithashtu ka deklaruar se për të ardhurat e realizuara nga qiraja e tokës bujqësore, tatimi në burim është paguar sipas llogaritjes së kryer nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë. Në cilësinë e provës, subjekti ka paraqitur shkresën nr. {***} prot., datë 28.01.2019, të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë, sipas së cilës rezultoi se shtetasi M. Rr., është i regjistruar për përgjegjësinë tatimore të tatimit të

²⁴ Me sip. 9960 m²; banesë me sip. 110 m², oborr me sip. 250 m²; si dhe 30 rrënjë ullinj, përfituar me AMTP në vitin 1992, në emër të kryefamiljarit M. Rr. dhe qiradhënësit M. Sh. Rr. më datë 01.01.2011, me afat 3-vjeçar deri në datë 01.01.2013, regjistruar kjo pasuri në regjistrat e pasurive të paluajtshme Fier, vol. {***}, {***}. {***} dhe vol. {***}, {***}. {***}, regjistruar më datë 27.04.2015, në ZVRPP Fier (trajtuar në seksionin e pasurive të deklaruara nga prindërit e bashkëshortit të subjektit).

mbajtur në burim dhe ka paguar tatimin mbi qiranë, në vlerën 362.850²⁵ lekë, si dhe nuk ka detyrime të papaguara deri në datën 28.01.2020.

14.18. Lidhur me të ardhurat e siguruara nga toka bujqësore, nga analizimi i deklarimeve që subjekti ka bërë për të ardhurat e siguruara nga qiradhënia e tokës bujqësore në deklaratën e pasurisë *vetting* me ato të që ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore 2011-2014, rezulton se ka mospërputhje për të ardhurat e siguruara pasi në deklaratën e pasurisë *vetting*, kjo e ardhur në total deklarohet në shumën 900.000 lekë, ndërsa shumatorja e të ardhurave nga qiraja e tokës bujqësore, sipas deklarimeve në DPV, në vitet 2011-2014 është në total 1.200.000 lekë. Nga sa më sipër, rezulton se vjehri i subjektit, sipas shkresës nr. {***} prot., datë 28.01.2019, lëshuar nga DRT Vlorë, ka paguar tatimin mbi të ardhurën, në shumën 362.850 lekë, për të ardhurat nga qiraja e apartamentit dhe e tokës bujqësore për të cilën tatimi korrespondues i përket të ardhurës nga qiraja e tokës në shumën 1.200.000 lekë.

14.19. Në analizë të këtij shkakut ankimi dhe të situatës faktike të evidentuar më sipër, *së pari*, konstatohet si më lart, se vlera e deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, si e përfituar nga qiradhënia e tokës bujqësore e familjes së origjinës së bashkëshortit, është në shumën 900.000 lekë. Në ankim, subjekti shpjegon se shuma e siguruar në total nga dhënia me qira e tokës bujqësore, është 1.200.000 lekë, aq sa është deklaruar në DVP-të, duke e konsideruar si lapsus deklarimin e bërë për këtë të ardhur në deklaratën e pasurisë *vetting*. Kolegji, në këtë drejtim, konstaton se subjekti, në përgjigje të pyetësorëve të hetimit administrativ, ka shpjeguar se shuma e përfituar nga qiradhënia e tokës bujqësore, është 1.200.000 lekë, vlerë e cila përputhet me deklaratimet periodike, si dhe me shumën për të cilën vjehri i subjektit, më datë 30.01.2020, ka paguar detyrimet tatimore lidhur me tatimin mbi të ardhurën (në masën 15% të vlerës totale 1.200.000 lekë).

14.20. Në drejtim të analizës së fakteve që kanë rezultuar nga hetimi administrativ lidhur me provueshmërinë e krijimit të kësaj të ardhure, Kolegji vlerësoi të konsiderojë të dhënat si vijon, duke i analizuar ato në mënyrë harmonike me njëra-tjetrën, si një proces logjik drejt përcaktimit të besueshmërisë së ekzistencës së kësaj marrëdhënieje dhe të ardhurave të krijuara prej saj në zbatim të së drejtës për vlerësimin e provave sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016.

14.21. Së pari, vlen të analizohet fakti që marrëdhënia e qirasë është e lidhur mes vjehrit të subjektit dhe vëllait të tij, në kushtet kur sipas arsytimit të bërë më sipër në këtë vendim, më lart, ai nuk mbarte detyrime të posaçme sipas ligjit nr. 9049/2003 dhe as subjekti gjithashtu, lidhur me të ardhurat e krijuara prej tij, në pozitën e një subjekti deklarues. Këto detyrime lindën rishtas me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 84/2016. Pavarësisht kësaj situatë ligjore, rezulton se në DPV-të e viteve përkatëse, 2011, 2012, 2013 e 2014, ka deklarime si të vjehrit të subjektit, por edhe të personit të lidhur për ekzistencën e kësaj marrëdhënieje qiraje dhe të

²⁵ Shkresa nr. {***}, datë 30.12.2020 dhe shkresa nr. {***} prot., datë 23.12.2020, në të cilat rezulton se M. Rr. është objekt i deklarimit individual të tatimit në burim mbi të ardhurat, i cili ka deklaruar në muajin 12/2019, dhe ka dorëzuar deklaratën më datë 28.01.2020 dhe likuiduar më datë 30.01.2020. M. Rr. ka deklaruar të ardhura nga qiraja në shumën 3.122.500 lekë dhe ka paguar tatimin e mbajtur në burim në vlerën 362.850 lekë. Në këtë vlerë janë përfshirë të ardhurat nga qiraja në shumën 1.931.875 lekë, për periudhën 2010-2018 dhe të ardhurat nga qiraja e tokës bujqësore në shumën totale (për vitet 2011-2014) 1.200.000 lekë. Vlera totale 3.131.875 lekë.

ardhurat e përfituara prej saj, në vlerën totale për katër vite, prej 1.200.000 lekësh. Në këtë kuptim, kjo e ardhur e pretenduar prej subjektit se ka shërbyer për krijimin qoftë të gjendjes së *cash-it* apo edhe në blerjen e kuotave të fondit Prestigj në Raiffeisen Bank, nuk është një vlerë e pretenduar rishtas gjatë procesit të rivlerësimit dhe e propozuar për t'u njohur si e tillë vetëm në funksion të përmirësimit apo justifikimit të analizës financiare. E parë si e tillë, ajo vlerësohet prej trupit gjykues si e dhënë që, në mënyrë të besueshme, tregon për përfitimin e këtyre të ardhurave në vitet përkatëse.

14.22. Gjithashtu, rezulton se kjo marrëdhënie e deklaruar në DPV-të e viteve përkatëse, është shoqëruar për efekt provueshmërie edhe me citimin e aktit që dokumenton këtë vullnet të palëve të përfshira në veprimin juridik, që është kontrata me datë 01.01.2011. Ky akt që është nënshkruar prej dy palëve kontraktore, është përshkruar në DPV-në e vitit 2011 si i tillë dhe i përbërë nga tri fletë, duke përshkruar saktësisht të dhënat që konstatohen edhe prej këqyrjes së aktit të administruar në dosjen e ILDKPKI-së, me paraqitjen e deklaratës së pasurisë *vetting*.

14.23. Rezulton se dhënia me qira e kësaj toke bujqësore, përkon me momentin kur subjekti së bashku me familjen e saj, përfshi prindërit e bashkëshortit, janë zhvendosur dhe kanë banuar në qytetin e Sarandës, për shkak të punësimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Gentiana Xhelili, si gjiqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë. Kjo e dhënë e bën të arsyeshëm veprimin e dhënies me qira të pasurive që gjendeshin në fshatin {***}, të cilat duke qenë kryesisht me natyrë bujqësore, nuk mund të përdoroheshin e të shfrytëzoheshin prej prindërve të bashkëshortit të subjektit, duke qenë në distancë prej tyre.

14.24. Kolegji konstaton se marrëdhënia e qiradhënies së tokës bujqësore në {***}, Fier, është e evidentuar në një kontratë të thjeshtë të lidhur ndërmjet vjehrrit të saj dhe vëllait të tij më datë 01.01.2011, e cila gjendet e administruar si provë në aktet e fashikullit të administruar nga ILDKPKI-ja në funksion të kontrollit të deklarimeve periodike dhe të deklaratës *vetting*. Kontrata e lidhur me anë të një shkrese të thjeshtë dhe jonoteriale, ka vlerën e saj provuese, konsideruar kushtet e një marrëdhënieje të posaçme, e lidhur mes vëllezërve dhe konfirmimit të lidhjes së saj në kohën e pretenduar, për shkak të deklaramit të saj ekzaktësisht në deklaratën periodike të vitit 2012. Në këtë kuptim, roli i noterit publik, para të cilit do të deklaroheshin vullnetet për lidhjen e kontratës, i cili do të konfirmonte jo vetëm deklaramin e tyre, por edhe kohën se kur ato ishin deklaruar, zëvendësohet në këtë rast me deklaramin në DPV-në e vitit 2012 të kontratës dhe përmbajtjes së saj. Kolegji sjell në vëmendje se Kodi Civil, në nenin 826²⁶, nuk parashikon detyrimisht lidhjen e kontratës para noterit për dhënien me qira të pasurive të paluajtshme që shërbejnë për kultivimin bujqësor për afate nën nëntë vjet, dhe në këtë kuptim, akti plotëson rekuizitat e kërkuara nga ligji për vlefshmërinë e tij.

14.25. Gjithashtu, fakti që vëllai i vjehrrit të subjektit të rivlerësimit ka vijuar të banojë në fshatin {***}, në të cilin gjendeshin edhe pasuritë bujqësore në pronësi të tij, duket si një e dhënë e arsyeshme që lejon administrimin dhe shfrytëzimin edhe të pasurive bujqësore të

²⁶ Në nenin 826 të Kodit Civil parashikohet:

“Kontrata e qirasë të pasurisë të paluajtshme që shërben për kultivimin bujqësor për një kohë mbi nëntë vjet, duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet në regjistrin publik”.

vjehrrit të subjektit, të cilat gjendeshin në të njëjtin vend me pasuritë e tij, duke e lehtësuar në këtë mënyrë, shfrytëzimin e tyre në drejtim të përfitimeve financiare.

Kolegji vëren se edhe vlera e përcaktuar për dhënien me qira të pasurive, në vlerën prej 300.000 lekësh në vit, apo 25.000 lekësh në muaj, duhet të lexohet si një e ardhur e arsyeshme, konsideruar pasuritë e dhëna me qira dhe marrëdhënien e posaçme mes palëve.

14.26. Për të gjitha këto arsye, të përmendura më lart, trupi gjykues arriti të krijojë bindjen se kjo marrëdhënie ka ekzistuar dhe të ardhurat e deklaruara prej saj janë përfituar realisht nga familja e subjektit të rivlerësimit në vitet 2011-2014, duke konkluduar se subjekti e arrin nivelin e besueshëm në krijimin e tyre sipas edhe testit të qëndrimit orientues të vendimit nr. 15/2021 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

14.27. Në vijim të arsyetimit të mësipërm, Kolegji vlerësoi edhe legjitimitimin e këtyre të ardhurave sipas standardit kushtetues dhe ligjor të nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016. Ashtu si për të ardhurat e krijuara prej qiradhënies së apartamentit, të arsyetuara më lart, edhe për këto të ardhura rezulton se vjehri i subjektit ka paguar detyrimet tatimore me vonesë, në janar të vitit 2020, sipas vërtetimit të Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë të cituar më lart. Në analizimin e sjelljes së subjektit dhe marrëdhënies së tij në raport me këto të ardhura dhe pagimit të detyrimeve tatimore me vonesë për to, Kolegji, pa dashur të bjerë në përsëritje, vlerëson se janë të njëjtat kushte dhe rrethana si ato të përshkruara në paragrafin 13.5, të cilat e shmangin subjektin e rivlerësimit nga përgjegjësia e drejtpërdrejtë për pagimin me vonesë të detyrimeve tatimore. Për këto arsye, Kolegji çmon se kjo rrethanë duhet të vlerësohet se e shëron edhe legjitimitetin e kësaj shume, dhe e sjell atë në standardin e së ardhurës të ligjshme, sipas nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016.

14.28. Në përfundim, Kolegji, lidhur me pasurinë likuiditet në vlerën 900.000 lekë, të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si gjendje *cash* në deklaratën e pasurisë *vetting*, pasi analizoi burimet e krijimit të saj, arriti në konkluzionin se subjekti justifikoi ligjshmërinë e krijimit të kësaj shume, në kuptim të parashikimit të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016. Në kontekstin e kontrollit të burimeve lidhur me këtë pasuri, Kolegji konstatoi se pasaktësitë e deklaruara në deklaratat periodike 2014 e 2015, lidhur me emërtimin e monedhës “Lek” në të vjetër apo të ri, është një pasaktësi që nuk mund të ngrihet në nivelin e shkeljes sipas nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, për sa kohë që ajo nuk është kryer në deklaratën e pasurisë *vetting*, por në deklarimet periodike të pasurisë. Po në këtë kontekst, Kolegji kontrolloi dhe vlerësoi ligjshmërinë e të ardhurave të krijuara nga marrëdhënia e qirasë së lidhur mes vjehrrit të subjektit dhe vëllait tij, për pasuritë në pronësi të personit të lidhur, tokë bujqësore, banesë dhe rrënjë ullinj, të ndodhur në fshatin {***}, në {***}, Fier, në shumën totale prej 1.200.000 lekësh, e të deklaruar nga subjekti e personat e lidhur në deklaratat periodike të viteve 2011-2014, të formalizuar në kontratën e qirasë së datës 01.01.2011, e deklaruar edhe kjo në deklaratat periodike prej vjehrrit të subjektit. Kolegji, pasi analizoi të gjitha faktet që kanë rezultuar nga provat e administruara, arriti në konkluzionin se subjekti provoi në një nivel të besueshëm se kjo marrëdhënie ka ekzistuar, dhe se shuma e deklaruar është përfituar si vlerë e kësaj qiraje, nga një burim i ligjshëm i parashikuar nga neni 4 i ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Kolegji vlerësoi

në të njëjtën mënyrë si më sipër, efektin e pagimit me vonesë të detyrimeve tatimore për të ardhurën nga vjehtëri i subjektit, duke konkluduar se edhe kjo e ardhur e kalon testin e qëndrimit orientues të dhënë nga Kolegji në vendimin nr. 15/2021 (JR) dhe, për pasojë, edhe kjo e ardhur do të trajtohet si e ligjshme në kuptim të këtij procesi. Pasaktësia e konstatuar lidhur me deklarin e shumës totale të kësaj të ardhure, ndonëse konfirmohet si e tillë, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, nuk cenon ligjshmërinë e të ardhurave të krijuara, përderisa është një deklarin i pasaktë që nuk afekton vlerësimin për burimin e krijimit të kësaj shume.

15. Kolegji mori në shqyrtim pretendimin e subjektit të rivlerësimit, me të cilin kundërshton *si jo të drejtë e të bazuar në situatën faktike analizën financiare të kryer për vitet 2006-2008 dhe 2009-2016 nga Komisioni për krijimin e pasurisë likuiditet, në vlerën prej 7.550.000 lekësh, të përdorur për blerjen e kuotave në fondin e investimit Prestigj pranë Raiffeisen Bank.*

15.1. Lidhur me këtë çështje, Kolegji konstaton se sipas vendimit të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme për të krijuar këtë pasuri/fond investimesh, në total në shumën 3.552.438 lekë, e përbërë prej diferencave negative: **(i)** për vitin 2011, në shumën (-) 146.021 lekë; **(ii)** për vitin 2012, në shumën (-) 757.872 lekë; **(iii)** për vitin 2013, në shumën (-) 965.442 lekë; **(iv)** për vitin 2014, në shumën (-) 1.126.578 lekë; **(v)** për vitin 2015, në shumën (-) 310.286 lekë; **(vi)** për vitin 2016, në shumën (-) 239.403 lekë.

15.2. Në ankim, subjekti pretendon se Komisioni në analizën financiare të kryer për periudhën 2006-2016, nuk ka përfshirë si të ardhura të ligjshme shumat e përfituara nga: **(i)** qiradhënia e apartamentit në Tiranë, në shumën 1.470.000 lekë; **(ii)** nga qiradhënia e tokës bujqësore në Fier, në shumën 1.200.000 lekë; si dhe **(iii)** të ardhurat e përfituara nga shitja e automjeteve në vitet 2013 dhe 2016; **(iv)** gjithashtu subjekti pretendon që gjatë hetimit ka shpjeguar se prindërit e bashkëshortit kanë disponuar që para martese kursime në *cash*, në vlerën minimale prej 1.000.000 lekësh, me burim nga shitja e një dyqani në {***} të Fierit, një pjesë e së cilës është përdorur gjatë jetesës së përbashkët gjatë periudhës 2006-2016, në varësi të nevojave familjare; **(v)** në drejtim të shpenzimeve, subjekti pretendon se analiza ekonomike e Komisionit është rënduar me të padrejtë me kostot e siguracionit të automjeteve, të cilat janë të përfshira në kostot e shpenzimeve të jetesës.

15.3. Lidhur me burimet e krijimit të kuotave në fondin e investimit Raiffeisen Prestigj, pranë Raiffeisen Bank, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e pasurisë *vetting*, ka deklaruar: *Blerjen e kuotave në fondin e investimit Raiffeisen Prestigj pranë Raiffeisen Bank, në datën 10.01.2017, në vlerën 7.556.000 lekë, pjesa takuese 50%. Si burim krijimi, subjekti ka deklaruar: a) shuma prej 4.000.000 lekësh, depozituar në Raiffeisen Bank, në datën 10.01.2017, që rrjedh nga kursimet familjare, ndër vite, nga marrëdhëniet e punës së deklaruesit dhe bashkëshortit të deklaruesit, kursim nga paga dhe qiraja e apartamentit në pronësi të prindërve të bashkëshortit M. dhe S. Rr. në llogarinë bankare nr. {***} në Raiffeisen Bank, të bashkëshortit A. Rr.; b) shuma prej 1.500.000 lekësh, nga kursimet e bashkëshortit në llogarinë e tij me nr. {***} në Raiffeisen Bank, në datën 10.01.2017, sipas njoftim debitimit, datë 10.01.2017, kursime që rridhnin nga paga nga marrëdhëniet e punës ndër vite dhe qiraja*

e apartamentit me vendndodhje në rrugën “{***}”, pall. nr. {***}, shk. {***}, k. {***}, Tiranë, me nr. pasurie {***}, vol. {***}, f. {***}, në pronësi të prindërve të bashkëshortit, M. dhe S. Rr.; c) shuma prej 2.025.761 lekësh, përfituar nga vendimi gjyqësor i formës së prerë nr. {***}, datë 22.1.2016, për të cilin është lëshuar urdhër ekzekutimi nr. {***}, datë 22.1.2016, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me objekt “Pagim dëmi pasuror dhe j pasuror nga pala e paditur shoqëria {***} sh.a”, ku një nga palët paditëse për të cilën është pranuar padia, është dhe deklaruesja Gentiana Xhelili, e ka kaluar në llogari nga një prej paditësve në këtë gjykim, znj. Z. M. sipas njoftim debitimit, datë 20.10.2016, nga Raiffeisen Bank, e cila me prokurën e posaçme nr. {***}, datë 3.08.2016, ka autorizuar motrën e saj, znj. Z. M., që të pranojë ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv, vendim gjyqësor nr. {***}, datë 22.1.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, dhe të depozitohet në emrin e deklarueses Gentiana Xhelili pjesën e saj takuese në llogarinë e saj bankare, vendim i cili është ekzekutuar dhe për të cilën nga përmbaruesi gjyqësor privat “{***}”, është marrë vendimi për pushimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv.

15.4. Me qëllim identifikimin e burimeve të ligjshme të përdorura për krijimin e shumës së investuar në fondin e investimit Prestigj pranë Raiffeisen Bank, në vlerën 7.556.000 lekë, Komisioni ka bërë një analizë financiare për periudhën 2006-2016, nga e cila rezulton se: Komisioni nuk ka përfshirë në analizë si të ardhura shumat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, me burim nga qiradhënia e apartamentit me vendndodhje në rrugën “{***}”, pall. nr. {***}, shk. {***}, k. {***}, Tiranë, dhe nga qiradhënia e tokës bujqësore në {***} të Fierit, të dyja këto pasuri, në pronësi të prindërve të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, me arsyetimin se për to nuk janë paguar detyrimet tatimore në momentin kur janë krijuar këto të ardhura. Gjithashtu, në analizën e kryer nga Komisioni, nuk është përfshirë gjendja e *cash*-it të disponuar nga prindërit e bashkëshortit (që para martese), sipas analizës së mësipërme, në vlerën prej 300.000 lekësh.

15.5. Lidhur me këto pretendime të subjektit të rivlerësimit, Kolegji konstatoi se, përveç sa ka analizuar më sipër në funksion të analizës që u përket periudhave 2006-2008 dhe 2009-2016, mbeten për t’u marrë në konsideratë pretendimet e subjektit të rivlerësimit se analiza financiare e Komisionit për vitet 2012, 2013, 2014, 2015, 2016 është rënduar me pa të drejtë, pasi janë përfshirë kostot e siguracionit të automjeteve, të cilat gjithashtu janë shpenzime që përfshihen në tërësinë e kostove të jetesës të aplikuara nga Komisioni. Lidhur me këtë pretendim, Kolegji analizon sa vijon.

15.6. Nga të dhënat e evidentuara në vendimin e Komisionit lidhur me analizën financiare të kryer, Kolegji konstaton se në vitet 2012, 2013, 2014, 2015, 2016, në këtë analizë janë përfshirë si shpenzim, përveç kostove të jetesës, edhe pagesat për siguracionin e automjetit të familjes së subjektit të rivlerësimit, të cilat në total për pesë vitet e mësipërme, janë në shumën 72.899 lekë. Kolegji vlerëson se ky shpenzim i ngarkuar familjes së subjektit prej Komisionit, ka rënduar me të padrejtë analizën financiare të këtyre pesë viteve, pasi ai është një shpenzim i përthithur nga elementet që përcaktojnë kostot e jetesës. Në këtë drejtim, Kolegji gjithashtu evidenton faktin se vetë Komisioni në jurisprudencën e çështjeve të tjera të shqyrtuara, nuk rezulton të ketë përfshirë në analizën ekonomike si shpenzim më vete këtë lloj shpenzimi, edhe kur ka pasur të dhëna të qarta për vlerat e shpenzuara në disa siguracione automjete. Në këtë

drejtim, Kolegji mori në konsideratë edhe jurisprudencën e tij²⁷, në të cilën, në situata të përafërta lidhur me shpenzime të ngjashme, siç janë ato të telefonisë, është arsyetuar se në rastet kur ka hasur shpenzime telefonie (të ngjashme me ato të sigurimit të automjetit të rastit objekt analize) që nuk tejkalojnë dukshëm vlera që mund të shpenzohen për këtë zë, nuk i ka trajtuar këto shpenzime si zë më vete në analizën financiare, por ato janë konsideruar si shpenzim i përfshirë në kategorinë e shpenzimeve të jetesës.

15.7. Për sa më sipër, Kolegji, pretendimin e subjektit të rivlerësimit për rëndim të analizës financiare të kryer nga Komisioni me shpenzimet e siguracionit të automjetit, e konsideron të drejtë dhe të argumentuar.

15.8. Bazuar në konkluzionet e mësipërme, Kolegji, në drejtim të kontrollit të analizës së Komisionit për periudhën 2008-2016, mbi shkaqet e ankimit të arsyetuara më lart, përfshiu si të ardhura të ligjshme: **(i)** shumën 1.470.000 lekë, të përfituar nga qiraja e apartamentit në Tiranë; **(ii)** shumën 1.200.000 lekë, të përfituar nga qiraja e tokës bujqësore; **(iii)** shumën 2.500 euro (ekuivalent me 350.525 lekë), të përfituar nga shitja e automjetit të dhuruar në vitin 2013, si dhe shumën 3.100 euro (ekuivalent me 419.337 lekë), të përfituar nga shitja e automjetit tip “Mercedes Benz” në vitin 2016; **(iv)** shumën 300.000 lekë, gjendje *cash* e krijuar nga prindërit e të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në periudhën para martese.

Në drejtim të shpenzimeve të përfshira në analizën ekonomike të Komisionit, Kolegji konsideroi si të drejtë pretendimin e subjektit për reduktimin e shpenzimeve për vitet 2012, 2013, 2014, 2015, 2016, me vlerat e siguracionit të automjeteve, në një vlerë totale prej 72.899 lekësh, me arsyetimin që pretendimi i subjektit është i drejtë, pasi këto shpenzime janë të përfshira në shpenzimet e kostove të jetesës.

15.9. Në përfundim të këtij arsyetimi, lidhur me pasurinë likuidet në vlerën prej 7.550.000 lekësh, të përdorur për blerjen e kuotave në fondin e investimit Prestigj pranë Raiffeisen Bank, e të deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, Kolegji, pasi analizoi burimet e krijimit të saj, në këndvështrim të konkluzioneve të mësipërme, lidhur me të ardhurat nga shitja e automjeteve dhe qiratë nga pasuria apartament dhe pasuria e ndodhur në fshatin {***}, konkludoi se subjekti i rivlerësimit rezultonte se gjendej në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të krijuar këtë pasuri, në vlerën prej 1.023.460 lekësh²⁸, për të gjitha vitet në të cilat shtrihet analiza financiare, 2006-2008 dhe 2009-2016.

²⁷ Në vendimin nr. 37/2022 (JR), datë 11.10.2022, për shpenzime të ngjashme, siç ishin ato të telefonisë, për të cilat Kolegji ka konkluduar se: “[...] Duke konsideruar se informacioni i ofruar nga dokumentacioni që subjekti ka paraqitur përgjatë hetimit administrativ në drejtim të shpenzimeve të telefonisë, si dhe nisur nga fakti që në rastet kur ka hasur shpenzime telefonie që nuk tejkalojnë dukshëm vlera që mund të shpenzohen për këtë zë, Kolegji nuk i ka trajtuar shpenzimet e telefonisë si zë më vete në analizën financiare, por ato janë konsideruar si shpenzim i përfshirë në kategorinë e shpenzimeve të jetesës [vlerë e cila është përlogaritur nga INSTAT-i sipas strukturës së shpenzimeve për konsum të Njësive Ekonomike Familjare (NjEF), në të cilën shpenzimet për komunikim zënë rreth 3,4% të vlerës totale], edhe në rastin objekt shqyrtimi, Kolegji çmoi që analiza financiare të mos ngarkohej me shpenzimet e telefonisë, duke e konsideruar në këtë mënyrë të drejtë pretendimin e subjektit”.

²⁸ Nga analiza financiare e kryer në Kolegji, subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë të burimeve financiare, përkatësisht në vitin 2009, në vlerën (-) 6.836 lekë; në vitin 2012, në vlerën (-) 213.268 lekë; në vitin 2013, në vlerën (-) 157.701 lekë; në vitin 2014, në vlerën (-) 545.678 lekë dhe në vitin 2015, në vlerën (-) 102.997 lekë.

15.10. Kjo situatë e konstatuar prej Kolegjit, ndonëse e vendos subjektin në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, së bashku me pasaktësinë e konstatuar më sipër, nuk vlerësohet se është në nivelin e duhur për të konsideruar se subjekti ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Kolegji vlerësoi këtë situatë në zbatim të parimeve të proporcionalitetit dhe objektivitetit në të njëjtin standard të përdorur prej tij edhe në raste të ngjashme, duke pasur në konsideratë edhe specifikat e rastit konkret, shpërndarjen në vite të diferencave negative në vlera relativisht të vogla apo jetesën në një ekonomi të përbashkët me prindërit e bashkëshortit, të cilët shfrytëzonin edhe kulturat bujqësore të krijuara në pasuritë në pronësi për të ndihmuar ekonominë familjare.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale dhe të cenimit të besimit të publikut

16. Në ankim, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur gjithashtu kundërshti edhe për sa u përket konkluzioneve të vendimit të Komisionit, lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale dhe të cenimit të besimit të publikut, konkretisht:

16.1. Subjekti i rivlerësimit e konsideron *si tërësisht të padrejtë dhe të paargumentuar konkluzionin e Komisionit se ka mangësi në drejtim të aftësive organizative për të përballuar ngarkesën e punës, plotësimin e standardeve minimale kohore, kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje në rendimentin e përfundimit të çështjeve gjyqësore.* Lidhur me këtë pretendim, Kolegji konstaton dhe analizon sa vijon.

16.2. Në vendimin e Komisionit lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit, ndër të tjera është arsyetuar se: *Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka mangësi në drejtim të aftësive organizative, si: për të përballuar ngarkesën e punës; plotësimin e standardeve minimale kohore; kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje në rendimentin e përfundimit të çështjeve gjyqësore; moskryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor; për mosshmangien e seancave gjyqësore joproductive; për të mos miradministruar dosjet gjyqësore, duke u bazuar në rregullshmërinë, plotësinë dhe saktësinë e dokumentacionit të dosjes, ka aftësi minimale kualifikuese. Mangësitë e konstatuara më lart, Komisioni vlerëson se nuk mund të ngrihen në nivelin e shkarkimit sipas pikës 4 të nenit 61 të ligjit nr. 84/29016, por duhen marrë në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes, duke u gjendur në kushtet e pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*

16.3. Lidhur me këtë qëndrim të Komisionit, subjekti i rivlerësimit në ankim pretendon se ajo ka plotësuar më së miri kërkesat për shqyrtimin sa më të shpejtë të çështjeve gjyqësore, duke shmangur maksimalisht shtyrjen e seancave për shkaqe që lidhen me të si gjyqtare apo me mospërgatitjen për gjykim. Në këtë drejtim, subjekti pretendon se ky qëndrim i Komisionit është tërësisht i rrëzuar nga qëndrimi që KLGj-ja ka mbajtur në raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, për periudhën 08.10.2013 - 08.10.2016, në të cilin, në rubrikën e “Aftësive organizative”, është shprehur se: [...] *Subjekti i rivlerësimit, në periudhën 8.10.2013 - 2.5.2014, ka kryer detyrën e gjyqtares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor*

Sarandë, ndërsa në periudhën 2.5.2014 - 8.10.2016 e në vazhdim, kryen detyrën e gjyqtares së Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, ku vazhdon dhe aktualisht. Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, për periudhën 3.5.2014 - 8.10.2016, konstatohet se subjekti ka përfunduar gjithsej 2052 çështje. Në bazë të germës "c" të pikës 3 të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari administrativ i shkallës së parë, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 150 gjykime çështjesh, që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje administrative. Ky rregull nënkupton një ngarkesë sasiore prej jo më pak se 450 gjykime çështjesh të tilla për tre vjet. Duke zbatuar këtë rregull, në rastin e subjektit të rivlerësimit, znj. Gentiana Xhelili, konstatohet lehtësisht se ka pasur ngarkesë sasiore tepër të lartë – thuajse 5-fishin e standardit minimal.

16.4. Në analizë të konkluzionit të Komisionit lidhur me kohën e shqyrtimit të çështjeve, në referim të përmbajtjes së raportit të KLGj-së për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimi, konstatohet se nga të dhënat statistikore që përcjell ky raport për çështjet e shqyrtuara nga subjekti i rivlerësimit, rezulton se ajo ka gjykuar rreth 700 çështje në vit, që përfaqësojnë 5-fishin e ngarkesës së sistemit të vlerësimit në aspektin sasior. Kjo shifër, në vlerësimin e Kolegjit, tregon që konkluzioni i Komisionit për vonesa apo zvarritje të gjykimeve nuk është i drejtë, pasi ai është një konkluzion i arritur pa konsideruar ngarkesën sasiore tepër të lartë, të cilën ka përballuar subjekti përgjatë periudhës së rivlerësimit. Nëse subjekti nuk do të kishte organizuar drejt e me efektivitet punën, atëherë përfundimi i këtij numri kaq të lartë gjykimesh do të ishte i pamundur.

16.5. Përveç sa më sipër, nën të njëjtën optikë, Kolegji vlerëson edhe vonesat në shqyrtimin e çështjeve, të cilat, sipas vlerësimit të Komisionit, tregojnë për një praktikë pune me defekte të subjektit. Në kushtet e përballimit të një ngarkesë që kapërcen disafish numrin mesatar të çështjeve të parashikuara sipas rregullores së KLGj-së për vlerësimin e aftësive profesionale, vonesat ditore në shqyrtimin e çështjeve apo dorëzimin e dosjeve, duhen konsideruar si një rrethanë fakti e përcaktuar nga ngarkesa tepër e lartë, e cila e bën objektivisht të pamundur respektimin e afateve, procedurave apo rregullave brenda të cilave duhet të kryhen veprime të caktuara procedurale. Në çfarë rasti, këto vonesa nuk rezultojnë të kenë ardhur për shkak të neglizhencës së subjektit të rivlerësimit, znj. Gentiana Xhelili, mungesës së përgjegjësisë në punë apo keqorganizimit të saj, për pasojë, në vlerësimin e Kolegjit, konkluzioni i Komisionit se ajo ka mangësi në drejtim të aftësive organizative që, për më tepër, kanë cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, gjendet i pabazuar. Kolegji vëren se nuk rezulton që vonesat në shqyrtimin e çështjeve të jenë praktikë pune e veprimtarisë së subjektit, të cilat të konsiderohen shkaqe/elemente në mbështetje të dhënies së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, në kuptim të nenit E, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës. Për sa më sipër, Kolegji e gjen të drejtë dhe të argumentuar këtë shkak ankimi.

- 17.** Lidhur me shkakun tjetër të ankimit, në të cilin subjekti i rivlerësimit kundërshton *si jo të drejtë dhe jo të vlerësuar sipas parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit konkluzionet e Komisionit lidhur me çështjen administrative me nr. {***}, datë 28.10.2014, regjistrimi që i përket paditësit D. H. kundër ZRVPP Vlorë dhe Komuna {***}, Vlorë, Kolegji konstaton dhe analizon sa vijon.*

17.1. Lidhur me këtë çështje, në vendimin e Komisionit, është konkluduar si vijon: *subjekti arriti të provojë faktin se gjatë gjykimit të kësaj çështjeje, janë kryer procedurat e nevojshme për caktimin e ekspertit dhe detyrat e lëna nga gjykata, vërtetuar kjo me kërkesën e palës paditëse, datë 10.12.2014, ku janë drejtuar pyetjet ndaj ekspertës topografe (faqe nr. 22 e dosjes së numërtuar), si dhe aktekspertimi ku ekspertja citon detyrat e lëna nga gjykata (faqe 30 e dosjes së numërtuar). Lidhur me konstatimet e tjera të Komisionit, subjekti, gjatë të gjitha fazave të gjykimit deri në shpalljen e vendimit përfundimtar, ka pasur vonesa në ndjekjen e procedurave, vonesa të cilat tregojnë një organizim jo të mirë të punës së subjektit. Gjithsesi, të analizuara më vete, këto vonesa nuk mund të ngrihen në nivelin e një shkakut për shkarkimin e subjektit.*

17.2. Në ankim, subjekti i rivlerësimit për këtë çështje kundërshton konkluzionet e Komisionit, duke pretenduar se: *Për sa i përket afatit të shqyrtimit të çështjes, data për pretendime përfundimtare është caktuar në muajin janar 2015, pasi në fund të muajit dhjetor dhe në fillim të muajit janar të çdo viti, gjykata ka më shumë ngarkesë pasi të gjitha vendimet e shpallura duhet të arsyetohen brenda vitit dhe në çdo fund viti kryhet procesi i mbartjeve të dosjeve, që zgjat rreth 20 ditë. Në raport me gjithë ngarkesën, vlerësoj se afati i gjykimit 2 muaj e 25 ditë nuk është afati i gjatë dhe nuk ka krijuar asnjë pasojë të asnjë pale ndërgjyqëse. [...] Komisioni nuk e ka hetuar çështjen me objektivitet dhe proporcionalitet pasi, sipas këtij vlerësimi të Komisionit, edhe fakti që vendimi i shkarkimit me nr. 369, datë 21.04.2021, që ka vendosur shkarkimin tim nga detyra, është arsyetuar jo brenda 30 ditëve nga data e përfundimit të seancës dëgjimore, por pas 61 ditëve nga përfundimi i seancës dëgjimore, dhe vetëm ky fakt do të çonte në përkufizimin: Komisioni nuk ka aftësi në drejtimin organizativ, vlerësim të cilin unë nuk mund ta bëj duke pasur parasysh kompleksitetin e çështjeve dhe volumin e çështjeve që ka Komisioni, nuk mund të pretendohet që një vendim të arsyetohet brenda afatit të parashikuar në ligj.*

Lidhur me konstatimin e tretë që dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor janë depozituar në sekretarinë gjyqësore në datën 10.02.2015, pas 19 ditëve nga shpallja e vendimit, jashtë afatit 7-ditor të përcaktuar nga neni 42, pika 3 e ligjit nr. 49/2012, shpjegoj se: së pari, afati 19 ditë përfshin dhe afatin që sekretarja gjyqësore e ka dorëzuar në sekretari pasi nuk është shënuar data kur unë e kam dorëzuar te sekretarja gjyqësore, e cila edhe për shkak të ngarkesës që kanë të gjitha sekretaret gjyqësore, nuk arrijnë dot që të dorëzojnë dosjet gjyqësore. Po kështu, afati 7-ditor është vendosur për një ngarkesë mesatare 150 çështje në vit dhe jo për 770 çështje në vit që kam gjykuar unë. Nuk ka ardhur asnjë pasojë që dosja është dorëzuar jashtë afatit 7-ditor, në ditën e 19.

Lidhur me konstatimin se seanca gjyqësore për diskutime përfundimtare është caktuar pas 1 muaji, në datë 22.01.2015, shpjegoj se seanca gjyqësore është caktuar për një muaj, për shkak të ngarkesës që kam pasur në muajin dhjetor, si dhe për shkak të procesit të mbartjeve që kryhet nga çdo gjykatë në fund dhe fillim të vitit, që kërkon një afat rreth 20 ditë.

17.3. Në referim të konkluzionit final të Komisionit për çështjen e regjistruar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, me nr. {***}, datë 28.10.2014, me palë paditëse D. H. dhe të paditur ZRVPP Vorë dhe Komuna {***}, Kolegji konstaton se ai përmban të dhëna

të sakta për sa u përket fakteve dhe kohës së ndodhjes së tyre. Kështu, rezultojnë i saktë konkluzioni se subjekti ka përfunduar afatin e shqyrtimit të çështjes për 2 muaj e 25 ditë dhe jo për 1 (një) muaj, siç e specifikon vendimi i KLD-së nr. {***}, datë 14.04.2010, “Për sistemin e vlerësimit të gjyqtarëve”, në nenin 4/ç dhe nenin 7²⁹, si dhe rezultojnë se subjekti ka dorëzuar vendimin e arsyetuar përtej afatit 7-ditor, të parashikuar nga neni 55 i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (në vijim “ligji 49/2012”), pasi rezultojnë ta ketë dorëzuar atë 19 ditë nga shpallja e vendimit, pra 12 ditë më vonë. Gjithashtu, rezultojnë se është i saktë edhe konstatimi i caktimit të seancës gjyqësore për depozitimin e konkluzioneve përfundimtare përtej afatit 15-ditor, të parashikuar nga neni 27, pika 1 e ligjit nr. 49/2012. Pavarësisht këtyre konstatimeve, Kolegji vlerëson se këto vonesa, ashtu siç edhe vetë Komisioni ka konkluduar, nuk mund të konsiderohen thelbësore në drejtim të matjes së indikatorit të aftësive organizative të subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimit të nenit 74 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e magjistratit në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 96/2016”). Vonesat e konstatuara apo mosrespektimi i afateve procedurale nuk kanë rezultuar se kanë ardhur për shkak të mungesës së aftësisë së subjektit për të organizuar punën, por për rrethana objektive, të cilat, duket se do të kishin vendosur çdo magjistrat në pozita të ngjashme.

18. Subjekti i rivlerësimit kundërshton *si jo të drejta, të bazuara në ligj e të trajtuara sipas parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit konkluzionet e Komisionit për çështjen e gjykuar prej subjektit, me palë paditëse E. K., E. B., V. B., K. B.(trashëgimtarët e z. A. B.), e palë të paditur ZVRPP-ja Vlorë, ZQRPP-ja Tiranë, person i tretë Avokatura e Shtetit Vlorë*. Lidhur me këtë shkak ankimi, Kolegji konstatoi dhe analizoi sa vijon.

18.1. Siç ka konstatuar edhe Komisioni në vendimin objekt shqyrtimi për këtë çështje, Ministria e Drejtësisë ka iniciuar një procedim disiplinor në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, lidhur me shkeljet e konstatuara në gjykimin e çështjes administrative me palë paditëse: E. K., E. B., V. B., K. B., palë e paditur ZVRPP-ja Vlorë, ZQRPP-ja Tiranë; person i tretë Avokatura e Shtetit Vlorë, me objekt “Kundërshtim akti administrativ nr. {***} prot., datë 2.10.2014, të ZVRPP-së Vlorë dhe aktin administrativ me nr. {***} prot., datë 6.11.2014, të ZQRPP-së. Detyrimin e ZVRPP-së Vlorë të kryejë regjistrimin fillestar të pronës për trashëgimtarët sipas AMTP-së, në emër të babait tonë të ndjerë A. B. dhe vendimit nr. {***}, datë 20.1.2000, të Bashkisë Himarë, z.k. {***}, Gjilekë, si dhe të pajisem me certifikatë pronësie”. Ky inspektim është iniciuar mbi bazën e ankesës së paraqitur pranë Ministrisë së Drejtësisë nga Task-Forca për Verifikimin e Ligjshmërisë dhe Mënyrës së Tjetërsimit të Pronave të Paluajtshme Shtetërore, pranë Kryeministrisë. Në vijim, ministri i Drejtësisë i ka propozuar KLD-së iniciimin e procedimit disiplinor ndaj subjektit të rivlerësimit, znj. Gentiana Xhelili, si dhe marrjen e masës disiplinore “Vërejtje me paralajmërim (vërejtje publike)”. KLD-ja, me vendimin nr. {***}, datë 24.1.2018, “Për shqyrtimin e kërkesës për procedimin disiplinor ndaj gjyqtarës Gentiana Xhelili”, ka vendosur rrëzimin e kërkesës. [...]

²⁹ Në vendimin e KLD-së nr. {***}, të datës 14.04.2010, të titulluar: “Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve” në nenin 7, “Shpejtësia”, përcaktohet se: “Me këtë kriter vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të zgjidhur në afate kohore të arsyeshme, çështjet që i janë caktuar për gjykim”.

18.2. Në përfundim të vlerësimit ligjor lidhur me këtë çështje, Komisioni ka konkluduar se: Rezulton se subjekti i rivlerësimit në rastin konkret ka shfaqur aftësi jo të mira organizative, pasi rezulton: (i) mospërputhje e plotë midis fakteve të pasqyruara në procesverbalin e seancës së shpalljes së vendimit dhe atyre të pasqyruara në vendimin e arsyetuar dhe të zbardhur, të administruar në dosjen gjyqësore; (ii) subjekti, edhe pasi ka rënë në dijeni të gabimit material në vendim, nuk rezulton që ta ketë korrigjuar kryesisht atë, sipas parashikimeve të nenit 312 të Kodit të Procedurës Civile; (iii) në vendim paraqiten të dhëna të pasakta nëpërmjet referimit në akte shkresore që nuk kanë lidhje me çështjen objekt gjykimi; (iv) dy procesverbale me të dhëna të kundërta lidhur me prezencën e ZVRPP-së Vlorë në seancën e dhënies së vendimit, datë 19.2.2015; (v) nuk është mbajtur procesverbal për seancën e pazhvilluar të datës 12.2.2014, e cila ishte planifikuar për diskutimet përfundimtare të palëve, në kundërshtim me parashikimet e nenit 118 të Kodit të Procedurës Civile; (vi) vendimi i arsyetuar, së bashku me dosjen gjyqësore, janë dorëzuar në sekretarinë gjyqësore më datë 2.3.2015, pas 11 ditësh, pra 4 ditë jashtë afatit të parashikuar nga neni 42/3 i ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar [...]. Për më tepër, që nga hetimi dhe shqyrtimi i kësaj çështjeje, rezulton se është shkelur e drejta e njëjës palë për të ankimuar vendimin e marrë, duke qenë në kushtet e mosnjohimit nga ana e gjykatës. [...] Si përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka aftësi të mira organizative dhe ka shkelur të drejtën e palës për t'u ankuar ndaj këtij vendimi me pasoja në kohë për palën, duke u gjendur në kushtet e pikave 2, 3 dhe 5 të nenit 74 të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

18.3. Në ankim, subjekti kundërshton këto konkluzione të Komisionit, duke pretenduar se: Kjo çështje është shqyrtuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, i cili me vendimin nr. {***}, datë 24.01.2018, ka vendosur të rrëzojë kërkesën e ministrit të Drejtësisë për dhënie mase disiplinore. Pra, jemi para zbatimit të parimit "gjë e gjykuar". [...] Mospasqyrimi i mungesës së palës së paditur, ZVRPP Vlorë, në pjesën hyrëse të vendimit, është vetëm një gabim material i gjykatës, që nuk e ka vendosur në mungesë këtë palë, ashtu siç pasqyrohet në procesverbalin e mbajtur më datë 19.02.2015. Ky gabim material në asnjë mënyrë nuk i ka sjellë palës së paditur humbjen e së drejtës kushtetuese të ankimit, pasi pala e paditur në momentin që e ka konstatuar këtë gabim, ka paraqitur në gjykatë kërkesë për ndreqje gabimi të vendimit nr. {***}, datë 19.02.2015. Kjo kërkesë është regjistruar në gjykatë në datën 24.04.2015, dhe në shortin e zhvilluar më datë 27.04.2015, kjo kërkesë është kaluar nga kryetari i Gjykatës Administrative si një kërkesë që duhet të gjykohet nga gjyqtari që ka dhënë vendimin për të cilin kërkohet ndreqja e gabimit dhe gjykata konform nenit 25 të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative", ka caktuar seancën për kryerjen e veprimeve përgatitore, duke caktuar si datë për zhvillimin e këtij gjykimi, datën 15.05.2015, ora 11:45.

18.4. Kolegji, në verifikim të situatës faktike mbi të cilën Komisioni ka bërë vlerësimin e mësipërm, konstaton si vijon:

i. Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, është regjistruar për gjykim çështja administrative civile nr. {***}, datë 17.11.2014, me të dhënat e përshkruara në paragrafin 18.1 të këtij vendimi³⁰.

ii. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, me vendimin nr. {***}, datë 19.02.2015, të gjykuar nga subjekti i rivlerësimit, ka vendosur:

- Pranimin e kërkesë padisë.

- Shfuqizimin e shkresës nr. {***} prot., datë 02.10.2014, të ZVRPP Vlorë dhe të shkresës nr. {***} prot., datë 06.11.2014, të ZQRPP Tiranë dhe detyrimin e ZVRPP Vlorë të kryejë regjistrimin fillestar të pronës së trashëgimlënësit A. B., në favor të paditësve si trashëgimtarë ligjorë, fituar me aktin e marrjes së tokës në pronësi, dhënë me vendimin nr. {***}, datë 20.01.2000, të Bashkisë Himarë, pasuri e cila ndodhet në zonën kadastrale nr. {***}, Gjilekë. Pjesë përbërëse e këtij vendimi gjyqësor është edhe akti i ekspertimit të ekspertes R. S..

- Detyrimin e palës së paditur të pajisë palën paditëse me certifikatë pronësie pas përfundimit të regjistrimit fillestar.

iii. Në vendimin nr. {***}, datë 19.02.2015, në pjesën hyrëse të vendimit nuk është bërë pasqyrimi i mungesës së palës së paditur ZVRPP Vlorë, të cilin subjekti edhe në ankim e konsideron si një gabim material të gjykatës, që nuk e ka përcaktuar “në mungesë” këtë palë, ashtu siç pasqyrohet në procesverbalin e datës 19.02.2015.

iv. Për këtë çështje, vetë subjekti në ankim shpjegon se: *Ky gabim material në asnjë mënyrë nuk i ka sjellë palës së paditur humbjen e së drejtës kushtetuese të ankimit, pasi pala e paditur, në momentin që e ka konstatuar këtë gabim, ka paraqitur në gjykatë kërkesë për ndreqje gabimi të vendimit nr. {***}, datë 19.02.2015. Kjo kërkesë është reregjistruar në gjykatë në datën 24.04.2015, dhe në shortin e zhvilluar më datë 27.04.2015, kjo kërkesë më është caktuar nga kryetari i Gjykatës Administrative, si një kërkesë që duhet të gjykohet nga gjyqtari që ka dhënë vendimin për të cilin kërkohet ndreqja e gabimit dhe gjykata, konform nenit 25 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative”, ka caktuar seancën për kryerjen e veprimeve përgatitore, duke caktuar si datë për zhvillimin e këtij gjykimi datën 15.05.2015, ora 11:45. Rezulton se po nga pala e paditur ZVRPP Vlorë është depozituar në sekretarinë gjyqësore të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, në datën 28.04.2015, vetëm 4 ditë pasi ishte bërë kërkesa për ndreqje gabimi, një kërkesë për heqjen dorë nga korrigjimi i gabimit, me arsyetimin se: "Duke qenë se në lidhje me këtë vendim, zyra do të marrë masa të tjera, kërkojmë tërheqjen e kërkesës me nr. {***} prot., datë 22.04.2015, për ndreqjen e gabimit material të vendimit nr. {***}, datë 19.02.2015. Kjo kërkesë është protokolluar në sekretarinë gjyqësore të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë në datën 28.04.2015 dhe është një kërkesë që është bërë nga vetë drejtuesja e institucionit të palës së paditur ZVRPP Vlorë, regjistruesja L. T.. Pas kërkesës së ZVRPP Vlorë, gjykata, bazuar në nenet 25 dhe 39 të ligjit nr. 49/2012, ka vendosur pushimin e gjykimit të kësaj kërkesë në seancën e caktuar të datës 15.05.2015, duke i dhënë të drejtën palës*

³⁰ Palë paditëse: E. K., E. B., V. B., K. B., palë e paditur ZVRPP-ja Vlorë, ZQRPP-ja Tiranë; person i tretë Avokatura e Shtetit Vlorë, me objekt “Kundërshtim akti administrativ nr. {***} prot., datë 2.10.2014, të ZVRPP-së Vlorë dhe aktin administrativ me nr. {***} prot., datë 6.11.2014, të ZQRPP-së. Detyrimin e ZVRPP-së Vlorë të kryejë regjistrimin fillestar të pronës për trashëgimtarët sipas AMTP-së në emër të babait tonë të ndjerë A. B. dhe vendimit nr. {***}, datë 20.1.2000, të Bashkisë Himarë, z.k. {***}, Gjilekë, si dhe të pajisem me certifikatë pronësie.

kërkuese edhe për të bërë ankim të veçantë. Nuk rezulton se ZVRPP Vlorë të këtë kryer ankim të veçantë kundër vendimit të pushimit, vendim i cili është marrë në zbatim të nenit 39/3 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizmin dhe funksionimin e gjykatave administrative”, ku parashikohet se “gjykata vendos pushimin e gjykimit kur paditësi heq dorë nga gjykimi”.

v. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, në bazë të nenit 312 të Kodit të Procedurës Civile, me vendimin nr. {***}, datë 07.10.2016, të dhënë nga subjekti i rivlerësimit, ka vendosur: “Pranimin e kërkesës”; “Korrigjimin e vendimit nr. {***}, datë 19.02.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, duke korrigjuar në këtë vendim dhe pasqyruar sipas situatës faktike, mungesën në shpalljen e vendimit të palës së paditur ZRPP Vlorë”. Ky vendim i është komunikuar ZVPRR Vlorë, më datë **17.10.2016**.

vi. Pala ZVRPP Vlorë, pasi është njohur me vendimin nr. {***}, datë 07.10.2016, “Korrigjim vendimi”, ka ushtruar ankim më datë **07.11.2016**. Me aktin nr. {***}, datë 10.11.2016, të emërtuar “Vendim për pranim ankimi”, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë ka konstatuar se ndaj vendimit të dhënë nga kjo gjykatë me nr. {***}, datë **19.02.2015**, ndrequr me vendimin nr. {***} akti, datë **07.10.2016** (i cili ka marrë formë të prerë më datë 24.10.2016), ka paraqitur ankim ZRVPP Vlorë, dhe se gjykata çmon se ankimi nga ana e palës së paditur ZRVPP Vlorë është bërë brenda afatit ligjor, dhe plotëson të gjitha kushtet e nenit 46 të ligjit nr. 49/2012. Për këtë arsye, kjo gjykatë ka vendosur për pranimin e ankimit, duke urdhëruar për dërgimin e ankimit së bashku me aktet që i bashkëlidhen dhe dosjen e gjykimit brenda 15 ditëve në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

vii. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. {***}, datë 04.12.2018, ka vendosur mospranimin e ankimit të bërë nga pala e paditur ndaj vendimit nr. {***}, datë 19.02.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, pasi ka çmuar se ankimi është paraqitur jashtë afatit 15-ditor të ankimit. Kjo gjykatë arsyeton se, sipas përcaktimeve të nenit 44 të ligjit nr. 49/2012, referuar nenit 443 të K.Pr.Civile, afati i ankimit në Gjykatën e Apelit kundër vendimeve të Gjykatës së Shkallës së Parë është 15 ditë, dhe se duke nisur numërimin e këtij afati nga dita e njoftimit të vendimit, datë 17.10.2016, afati për paraqitje të ankimit përmbushet më datë **01.11.2016**.

viii. KLD-ja, me vendimin nr. {***}, datë 24.01.2018, ka vendosur të rrëzojë kërkesën e ministrit të Drejtësisë, të paraqitur me shkresën nr. {***} prot., datë 03.03.2016, për dhënien ndaj gjyqtarës Gentiana Xhelili të masës disiplinore “Vërejtje publike”, lidhur me shkeljet e konstatuara në gjykimin e çështjes së mësipërme.

18.5. Kolegji, nga analizimi i qëndrimit të vendimit të Komisionit për këtë çështje, vëren se në të janë konsideruar si mangësi të gjitha elementet e evidentuara si të tilla në vendimin e KLD-së nr. {***} të datës 24.01.2018, por me një vlerësim të ndryshëm, pasi ky organ (KLD) ka konkluduar se duke qenë se kemi të bëjmë me mangësi që lidhen vetëm me një vendim gjyqësor, nuk i ka konsideruar ato si shkaqe që përlligjin dhënien e masës disiplinore. Sipas pretendimeve të subjektit, nga shkeljet që evidentohen nga Komisioni në gjykimin e kësaj çështjeje, nuk rezulton se ka ardhur ndonjë pasojë, si në aspektin material (zgjidhjes në themel të çështjes), ashtu dhe në atë procedural.

18.6. Komisioni, në përfundim të vlerësimit të tij lidhur me këtë çështje, ka konkluduar se subjekti nuk ka aftësi të mira organizative dhe ka shkelur të drejtën e palës për t’u ankuar ndaj

këtij vendimi, me pasoja në kohë për palën, duke u gjendur në kushtet e pikave 2, 3 dhe 5 të nenit 74 të ligjit nr. 96/2016, duke arsyetuar se mangësitë e gjyqimit të kësaj çështjeje, si dhe në tërësi ato të gjetura gjatë vlerësimit të aftësive profesionale, nuk mund të ngrihen në nivelin e një shkaku shkarkimi sipas nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, por duhen marrë në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes, duke u gjendur në kushtet e pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

18.7. Për këtë çështje, Kolegji vlerëson se konkluzionet e Komisionit lidhur me situatën faktike, qëndrojnë dhe konsiderohen si shkelje në drejtim të aftësive të subjektit për organizim, por edhe të njohurive të ligjit. Në këto rrethana, Kolegji çmon se subjekti i rivlerësimit ka lejuar për shkaqe të paktën të pakujdesisë që, në vendimin e themelit të çështjes me nr. {***}, datë 19.02.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, të mos pasqyrohet saktësisht prezenca e palëve në seancë gjyqësore, detyrë e cila duhej të ushtrohej nga subjekti i rivlerësimit, znj. Gentiana Xhelili, në cilësinë e gjyqtares së çështjes, e cila ka përgjegjësinë për saktësinë e të dhënave të vendimit gjyqësor që jepet e nënshkruhet prej saj. Përveç kësaj shkeljeje, Kolegji vlerëson se edhe reagimi me vonesë ndaj korrigjimit të këtij gabimi, të pranuar edhe prej asaj vetë, përfaqëson një sjellje me neglizhencë në drejtim të garantimit të të drejtave të palëve për të ushtruar ankim dhe zbatimit të parimit të sigurisë juridike, i cili nuk duhet të lejojë përfshirjen e të dhënave të pavërteta në vendimet gjyqësore të cilat janë të detyrueshme për palët në proces e institucionet. Subjekti rezulton se ka vendosur kryesisht korrigjimin e vendimit lidhur me mungesën e palës së paditur, pasi pala e paditur vetë, është tërhequr nga kërkesa për ndreqje gabimi dhe e ka bërë këtë veprim pas kalimit të një viti e pesë muajve. Ndërsa pala e paditur është tërhequr prej kërkesës për ndreqje në datën 15.05.2015, për motivet e saj, subjekti në dijeni të faktit që vendimi i dhënë prej tij përmbante një gabim që duhej ndrequr, nuk ka vepruar kryesisht që në atë moment për të ndrequr një pasaktësi të shkaktuar edhe prej neglizhencës/pakujdesisë së tij, për të kontrolluar në nivelin e detyrës përmbajtjen e vendimit gjyqësor që kishte nënshkruar.

18.8. Pavarësisht se jo vetëm prej sjelljes së subjektit, por dhe për shkaqe që lidhen me sjelljen e palës së paditur, e cila jo vetëm është tërhequr prej kërkesës për korrigjim të vendimit, por edhe ka paraqitur jashtë afatit ligjor ankimin pas ndreqjes së bërë prej subjektit të rivlerësimit, pasoja e mosushtrimit në kohë e në përputhje me dispozitat ligjore të ankimit, ka ardhur dhe është evidente.

18.9. Në këtë kuptim, Kolegji konfirmon konkluzionet e Komisionit lidhur me këtë çështje, të cilat duket se kanë treguar mangësi në punën e subjektit që lidhen me indikatorin e aftësive organizative, parashikuar nga neni 74 i ligjit nr. 96/2016.

19. Në ankim, subjekti i rivlerësimit kundërshton *si jo të drejta dhe të bazuara në ligj edhe konkluzionet e Komisionit lidhur me analizimin e ankesave të paraqitura nga: (i) {***}; dhe (ii) Bashkia Konispol.* Për këtë shkak ankimi, Kolegji konstaton dhe analizon sa vijon.

19.1. Lidhur me ankesën e {***}, e cila është ankuar në KLGj për mosrespektim formal të ligjit dhe zvarritje të gjyqimit nga subjekti i rivlerësimit në shqyrtimin e çështjes civile me objekt: “Pavlefshmëri të pjesshme të vendimit të ish-KKKP-së Sarandë”, Komisioni ka

analizuar dhe konkluduar sa vijon: *Pas analizimit të shpjegimeve dhe provave të paraqitura, evidentohet se çështja paraqitet mjaft komplekse dhe bëhej fjalë për shfuqizimin e shumë vendimeve të Komisionit të Kthimit të Kompensimit të Pronave që kishin kthyer në natyrë një sip. 124 ha pyll dhe 273 ha kullotë. Në seancën e datës 17.1.2013, rezulton se gjykimi është shtyrë për arsye shëndetësore të subjektit, ndërsa seancat e tjera nuk pasqyrohen saktë në procesverbale se përse janë shtyrë.*

19.2. *Lidhur me kërkimin për sigurim padie, rezulton se pala paditëse, nëpërmjet përfaqësuesit të saj, ka deklaruar se kërkon që gjykata të shprehet në seancë gjyqësore për masën e sigurimit të padisë, pasi të sjellin provat që e legjitimojnë këtë kërkim, provuar kjo me procesverbalin e seancës së datës 19.12.2012. Komisioni vëren se në procesverbal, gjykata, bazuar në nenin 125, ka vendosur të shprehet për kërkesën e sigurimit të padisë në seancë gjyqësore, kur palët e paditura të sjellin provat. Më tej, Komisioni vlerëson se shpallja e moskompetencës nga subjekti, me vendim përfundimtar jothemeli nr. {***}, datë 24.1.2014, ka ndikuar në zvarritjen e procesit gjyqësor. Kjo zvarritje e gjykimit ka ardhur si rezultat i mosorganizimit të punës nga subjekti, duke u gjendur në kushtet e pikave 2, 3 dhe 5 të nenit 74 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.*

19.3. *Në ankim, lidhur me këtë çështje, subjekti kundërshton konkluzionet e Komisionit duke pretenduar se Komisioni ka vlerësuar me të padrejtë, për shkak se nuk ka konsideruar se: Shpallja e moskompetencës nga ana ime nuk ka ndikuar në zvarritjen e gjykimit pasi kompetenca e një gjykate përbën një parim të rëndësishëm të procesit të rregullt gjyqësor³¹. Shpallja e moskompetencës lëndore për çështjen që unë kam gjykuar, është kryer në zbatim të Kodit të Procedurës Civile dhe ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative”, që sapo kishte filluar zbatimin në datën 4 nëntor 2013, kur filluan të funksiononin gjykatat administrative në Republikën e Shqipërisë. Në asnjë moment nuk kanë qenë veprimet e mia si gjyqtare që kanë zvarritur gjykimin, por kompleksiteti i çështjes, sjellja e vetë palëve ndërgjyqëse, hyrja në fuqi e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative”, që solli një konfuzion në gjithë trupën gjyqësore lidhur me kompetencën lëndore të Gjykatës Administrative, lidhur me kundërshtimin e vendimeve të Komisionit të Pronave.*

19.4. *Aq e diskutueshme dhe e debatueshme ka qenë kompetenca e gjykatave në Shqipëri, sa dhe vetë Gjykata e Lartë ka nxjerrë vendime unifikuese të ndryshme lidhur me gjykatën kompetente për shqyrtimin e padive me objekt civil ose administrativ.*

19.5. *Subjekti ka sjellë në vëmendje të Komisionit vendimet unifikuese të Kolegjeve të*

³¹ *Në drejtim të kompetencës, subjekti ka referuar në ankim se:*

*“Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në vendimin nr. {***}, datë 20.11.2018, është shprehur se: “Kolegji Civil e gjen me vend të rikonfirmojë qëndrimin se kompetenca e gjykatës për gjykimin e një mosmarrëveshjeje është shumë e rëndësishme, si element që garanton procesin e rregullt ligjor. Nëse një gjykatë nuk ka juridiksion/kompetencë për të gjykuar çështjen objekt shqyrtimi, në përputhje me dispozitat që zbatohen sipas legjislacionit përkatës, nuk mund të kryejë asnjë veprim procedural. Në përcaktimin e kompetencës lëndore/tokësore ose funksionale, gjykata i referohet identifikimit të natyrës së mosmarrëveshjes, nëse është e natyrës civile apo administrative, përfshihet ose jo në territorin ku shtrin veprimtarinë e saj gjykata në fjalë, ose gjykimi i çështjes i përket gjykatës së shkallës së parë, ose një gjykate më të lartë, që në rastin në shqyrtim, është gjykata e apelit në territorin e së cilës ndodhet resi (sendi)”.*

Bashkuara të Gjykatës së Lartë, përkatësisht vendimin unifikues civil nr. 4, datë 10.12.2013³², vendimin unifikues administrativ nr. 3, të shqyrtuar në seancën gjyqësore publike të datës 04.04.2014³³ dhe të datës 28.04.2014³⁴, të cilat kanë përcaktuar në mënyrë evolutive se përcaktimi i kompetencës lëndore të gjykatave administrative varet nga një sërë rrethanash që lidhen me kërkimin e padisë, organin administrativ që ka nxjerrë aktin, koneksitetin e kërkimeve dhe natyrat e ndryshme të tyre.

19.6. Në këto kushte, sipas pretendimit të subjektit: *Në rastin që unë kam gjykuar dhe kam vendosur shpalljen e moskompetencës lëndore, e kam vendosur në bazë të Kodit të Procedurës Civile dhe ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative". Kështu në nenin 61 të K.Pr.Civile të vitit 2014, parashikohet se: "Gjykata, kur konstaton se nuk është kompetente për gjykimin e çështjes kryesisht ose me kërkesën e palëve, vendos moskompetencën e saj dhe i dërgon aktet në gjykatën kompetente. Po kështu, në nenin 13 të ligjit nr. 49/2012, parashikohet se: "Moskompetenca lëndore dhe funksionale ngrihet edhe kryesisht në çdo gjendje e shkallë të gjykimit". Pra, edhe në rastin kur jemi në diskutime përfundimtare, prevalon parimi i procesit të rregullt gjyqësor që të gjykohesh nga një gjykatë kompetente dhe jo shpejtësia e gjykimit, pasi do të passillte përsëri prishje të vendimit dhe zvarritje të gjykimit. Moskompetenca është shpallur pasi është vlerësuar nga bindja e brendshme e gjykatës, pasi gjykatat administrative janë krijuar në muajin nëntor të vitit 2013 dhe, për këtë arsye, është vendosur shpallja e moskompetencës në janar të vitit 2014, pasi është vlerësuar se kjo çështje ishte në kompetencë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë.*

19.7. *Vendimi unifikues nr. 4, datë 10.12.2013, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, i cili ka përcaktuar se: "Kur në objektin e gjykimit kundërshtohet vendimi i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave apo Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, kjo çështje do të konsiderohet si mosmarrëveshje civile dhe do të shqyrtohet nga gjykata që ka kompetencë gjykimin e mosmarrëveshjeve civile", është botuar në Fletoren Zyrtare në muajin mars të vitit 2014, pra pas dy muajsh pasi unë kam shpallur moskompetencën dhe, për këtë arsye, nuk kishte asnjë pengesë që unë të mos shpallja*

³² Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë përcaktuar se: "Kur në objektin e gjykimit kundërshtohet vendimi i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave apo Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, kjo çështje do të konsiderohet si mosmarrëveshje civile dhe do të shqyrtohet nga gjykata që ka kompetencë gjykimin e mosmarrëveshjeve civile".

³³ Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë vendosur se: "Nëse në një gjykim civil paraqitet një kundërpadi e natyrës administrative, gjykata që po shqyrton padinë, nuk mund të shqyrtojë këtë kërkim të të paditurit për shkak të mungesës së kompetencës lëndore të gjykatës që po shqyrton padinë. Nëse në gjykim administrativ paraqitet një kundërpadi e natyrës civile, gjykata që po shqyrton padinë, nuk mund të marrë në shqyrtim edhe kundërpadinë, për shkak se i mungon kompetenca lëndore e saj".

³⁴ Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë përcaktuar se: "1. Çështjet në të cilat gjatë gjykimit është paraqitur një kundërpadi, e cila ka natyrë të ndryshme nga ajo e padisë (respektivisht administrative ose civile), në rast se kundërpadia është paraqitur në gjykatë para datës 04.11.2013, do të vazhdojnë të gjykohen në gjykatën kompetente për shqyrtimin e padisë, si në gjykimin në shkallë të parë, gjykatë të apelit apo Gjykatë të Lartë. 2. Çështjet të cilat në objektin e tyre kanë disa kërkime, si të natyrës civile, dhe administrative, kërkime të cilat janë paraqitur përpara datës 04.11.2013, do të vazhdojnë të gjykohen nga gjykata ku ato janë paraqitur".

Shih: http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Rezultatet_e_Kerkimit_2254_1.php?search=vendim+unifikues+nr.3+dat%C3%AB+28.04.2014.

moskompetecën lëndore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

19.8. Në drejtim të kohës së marrë për shqyrtimin e kësaj çështjeje, si element përbërës i organizimit dhe drejtimit të punës, subjekti në ankim parashtron se: *Në seancën e datës 06.03.2013, kam shtyrë çështjen pasi pala e paditur ka kërkuar kohë të njihet me provat e paditësit. Në asnjë nga seancat, përveç seancës së datës 17.01.2013, që gjykimi është shtyrë për arsye shëndetësore të miat, asnjë seancë tjetër nuk është shtyrë për shkakun tim, por për shkak të vetë kërkesave të palës paditëse dhe për shkak të kompleksitetit të çështjes, pasi bëhej fjalë për shfuqizimin e shumë vendimeve të Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave që kishin kthyer në natyrë një sipërfaqe 124 ha pyll dhe 273 ha kullotë. Pra, nga unë si gjyqtare e çështjes, nuk ka pasur zvarritje të gjyqimit, përkundrazi, po të analizojmë dhe historikun se si ka vijuar gjykimi i kësaj çështjeje, rezulton se pala paditëse, {***}, ka qenë ajo që ka zvarritur gjykimin, pasi ka inicuar një gjykim për të cilin pas tri vitesh pasi i është drejtuar gjykatës me kerkesëpadi, ka bërë kërkesë për heqje dorë³⁵ nga gjykimi.*

Në këtë drejtim, subjekti thekson se pala paditëse, {***}, ka paraqitur kërkesë për heqje dore nga gjykimi i çështjes, duke pranuar se nuk ka më interes të gjykohet kjo padi, duke e zhvlerësuar me qëndrimin e saj pretendimin e kësaj komune për zgjatje të procesit gjyqësor.

19.9. Lidhur me këtë çështje, Kolegji konstaton se në fashikullin e hetimit administrativ të Komisionit, gjendet i administruar edhe akti i kontrollit i datës 10.09.2014, i mbajtur nga inspektorët e KLD-së mbi vendimin civil {***}, datë 24.01.2014, kontroll i inicuar mbi bazën e informacionit të përcjellë pranë këtij organi nga kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, me shkresën nr. {***} prot., datë 21.04.2014. Në këtë akt kontrolli³⁶, inspektorët e KLD-së, pas analizimit të dosjes gjyqësore, kanë arritur në përfundimin se: *Për efekt të këtij inspektimi, çmujmë se për sa i përket faktit që gjyqtarja nuk ka zbatuar vendimin unifikues nr. 4, datë 10.12.2013, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ajo nuk mund të mbajë përgjegjësi për sa i përket procedimit disiplinor. Arrijmë në këtë përfundim pasi vendimi nr. 4, datë 10.12.2013, i Kolegjeve të Bashkuara është botuar në Fletoren Zyrtare, pra është bërë i njohur botërisht për të gjithë shtetasit, përfshirë këtu edhe gjyqtaren Gentiana Xhelili më datë 07.03.2014 (Fletorja Zyrtare nr. 126), ndërkohë që gjyqtarja ka dhënë vendimin e saj më datë 24.01.2014, pra një muaj e 14 ditë para njohjes së përmbajtjes së vendimit unifikues të sipërcituar.*

19.10. Në drejtim të situatës faktike të shqyrtimit të kësaj çështjeje, Kolegji gjithashtu konstaton se në fashikullin e hetimit administrativ, gjendet edhe vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë nr. {***}, datë 06.05.2015, me palë paditëse {***} dhe palë të paditur E. Sh., B. J. dhe KKK Pronave, i cili i përket rigjyqimit të çështjes pas shpalljes nga Gjykata e Lartë si

³⁵ Si provë, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision vendimin nr. {***}, datë 06.05.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, në të cilin është vendosur pushimi i gjyqimit të çështjes civile, pasi në seancën e datës 06.05.2015, përfaqësuesi i palës paditëse {***} ka kërkuar pushimin e gjyqimit, pas një viti që çështja ishte regjistruar.

³⁶ Mbi bazën e këtij raporti të inspektorëve të KLD-së, informacioni i kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, që lidhet me vendimin nr. {***}, datë 24.01.2014, që ka të bëjë në thelb me shqetësimin për moszbatim të vendimit unifikues nr. 4, datë 10.12.2013, të botuar në Fletoren Zyrtare më datë 07.03.2014, është arkivuar me urdhrin e arkivimit të kryeinspektorese së KLD-së më 15.09.2014.

gjykatë kompetente. Sipas këtij vendimi, në seancën e datës 06.05.2015, tashmë në rigjykimin e çështjes, përfaqësuesi i palës paditëse, av. V. H., ka kërkuar heqjen dorë nga gjykimi i padisë, duke kërkuar pushimin e gjykimit. Kjo rrethanë e cila rezulton të jetë shkaku determinant i përfundimit të këtij procesi gjyqësor, duket se mbështet pretendimin e subjektit se ajo nuk ka cenuar të drejtat e palës paditëse me gjykimin e saj, pasi rezulton se është vetë kjo palë që ka hequr dorë nga gjykimi i çështjes, duke refuzuar të vijojë me kërkimin e së drejtës së pretenduar si të shkelur. Nga sa analizuar më sipër, duhet konsideruar gjithashtu se të dhënat e çështjes tregojnë për kompleksitetin e saj, i cili është pranuar edhe në arsyetimin e vendimit të Komisionit³⁷, duke e cilësuar si të tillë, nisur nga fakti se objekt kërkimi i padisë janë shfuqizimet e disa vendimeve të Komisionit të Kthimit e të Kompensimit të Pronave, që kishin kthyer në natyrë 124 ha pyll dhe 273 ha kullotë.

Në vlerësim të kësaj situatë, Kolegji çmon se vetëm fakti që Gjykata e Lartë ka konkluduar për prishjen e vendimit të dhënë nga subjekti i rivlerësimit për shpalljen e moskompetencës lëndore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, nuk duhet të konsiderohet si një shfaqje e mangësisë së subjektit në drejtim të aftësisë për të njohur ligjin dhe për të marrë në kohën e duhur vendimet. Sipas jurisprudencës unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, konstatohet se edhe këto kolegje kanë elaboruar me kalimin e kohës qëndrimet lidhur me përcaktimin e kompetencës së Gjykatës Administrative në raport me ato të juridiksionit të përgjithshëm, në varësi të kërkimeve të padive apo elementeve të tjera që përcaktojnë kompetencën lëndore sipas ligjit nr. 49/2012. Vendimi i subjektit, i marrë në analizë në këtë rast, rezulton të jetë marrë afër në kohë me ngritjen dhe funksionimin e gjykatave administrative në vend, proces i cili u konsiderua si një risi në vetë zhvillimin e sistemit të drejtësisë në vend. Në këtë kontekst, vendimi i parë i marrë prej Kolegjeve të Bashkuara, që synonte të unifikoje disa kritere për përcaktimin e kompetencës së këtyre gjykatave, rezulton të jetë botuar në Fletoren Zyrtare dhe të ketë prodhuar fuqi juridike, pasi subjekti i rivlerësimit të kishte marrë vendimin për shpalljen e moskompetencës lëndore. Në këtë kuptim, nuk vlerësohet e drejtë t'i kundërdrejtohet subjektit ky vendim si i detyrueshëm për zbatim. Kolegji vlerëson se vendimi i marrë prej saj për shpalljen e moskompetencës, përfaqëson një qëndrim të subjektit të pranueshëm në raport me ligjin dhe rrethanat e faktit, për pasojë ai nuk mund të konsiderohet se është marrë në shkelje të ligjit në kuptim të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit. Ai nuk rezulton të jetë marrë as në një kohë të vonë, duke shkaktuar zvarritjen e procesit, për sa kohë është marrë afër në kohë, pas ngritjes dhe funksionimit të gjykatave administrative.

19.11. Për sa i përket afatit të gjykimit të çështjes, Kolegji vëren se Komisioni në vendim evidenton se në seancën e datës 17.01.2013, rezulton se gjykimi është shtyrë për arsye shëndetësore të subjektit, ndërsa seancat e tjera nuk pasqyrohen saktë në procesverbale se përse

³⁷ Komisioni në paragrafin 272 arsyeton: “Pas analizimit të shpjegimeve dhe provave të paraqitura, evidentohet se çështja paraqitet mjaft komplekse dhe bëhej fjalë për shfuqizimin e shumë vendimeve të Komisionit të Kthimit të Kompensimit të Pronave që kishin kthyer në natyrë një sip. 124 ha pyll dhe 273 ha kullotë. Në seancën e datës 17.01.2013, rezulton se gjykimi është shtyrë për arsye shëndetësore të subjektit, ndërsa seancat e tjera nuk pasqyrohen saktë në procesverbale se përse janë shtyrë”.

janë shtyrë. Lidhur me kohën e gjykimit të çështjes, subjekti në ankim³⁸ referon se arsyet e shtyrjes së seancave gjyqësore kanë qenë kryesisht për shkak të mosprezencës së palëve ndërgjyqëse, shpjegime të cilat konfirmohen nga të dhënat e çështjes. Në këto kushte, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë shkaktuar zvarritje të procesit për shkak të mangësive profesionale apo sjelljes së pakujdesshme, ndërsa rezulton se në një pjesë të madhe, shtyrja e seancave ka ndodhur për shkaqe procedurale, për shkak të qenies së një procesi gjyqësor me shumë palë ndërgjyqëse.

19.12. Në analizë të kësaj situatë, Kolegji çmon se konkluzionet e Komisionit, sipas të cilave subjekti ka shkaktuar zvarritje të procesit për shkak të marrjes së vendimit për shpalljen e moskompetencës dhe shtyrjen e seancave, nuk janë të drejta. Sipas vlerësimit të Kolegjit, subjekti i rivlerësimit, znj. Gentiana Xhelili, ka marrë vendimin e mësipërm në ushtrim të kompetencave të saj si gjyqtare dhe nuk rezulton të mos ketë administruar procesin gjyqësor në përputhje me rregullat procedurale apo në shkelje të të drejtave të palëve pjesëmarrëse.

19.13. Lidhur me ankesën e Bashkisë Konispol³⁹, e cila ankohet ndaj veprimtarisë gjyqësore të subjektit dhe pretendon zvarritje të qëllimshme të gjykimit në shqyrtimin e çështjes⁴⁰, si dhe shpalljen e moskompetencës me qëllim zvarritjen e gjykimit të çështjes, rezulton se Komisioni ka arsyetuar se: *Pas analizimit, Komisioni konstatoi se gjykimi i çështjes ka zgjatur në periudhën kohore prej 1 viti, 2 muajsh e 29 ditësh, tej afatit 6-mujor të përcaktuar në germën "c" të nenit 5 të vendimit nr. {***}, datë 14.04.2010, të KLD-së, "Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore".*

19.14. Lidhur me këtë çështje, subjekti i rivlerësimit në ankim, ashtu si edhe në parashtrimet për rezultatet e hetimit, ka shpjeguar se: *Nga 20 seanca të kryera, vetëm 2 (dy) prej tyre janë shtyrë për arsye shëndetësore të gjyqtarës, ndërsa pjesa tjetër janë shtyrë për njoftim palësh apo për shkak të mungesës së mbrojtësve ligjorë të tyre. Pretendimi se subjekti ka shkaktuar zvarritje të procesit, duke shpallur moskompetencën lëndore, nuk qëndron, për të njëjtat arsye të shpjeguara në gjykimin e çështjes me palë paditëse {***}, duke shpjeguar se edhe në këtë rast, vendimi unifikues nr. 4, datë 10.12.2013, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, që ka përcaktuar se: "Kur në objektin e gjykimit kundërshtohet vendimi i Komisionit të Kthimit*

³⁸ Lidhur me ecurinë e gjykimit të çështjes, me palë të paditur Komunën Lapardha, subjekti shpjegon se: *"Seanca e parë gjyqësore është zhvilluar në datën 10.01.2013 dhe është shtyrë me kërkesë të vetë palës paditëse, e cila nëse do të kishte qenë urgjente, shqyrtimi i kërkesës për sigurim padie do të ishte paraqitur në gjykim. Po kështu, seanca tjetër e radhës është caktuar më datë 17.01.2013, ora 13:00, e cila nuk është zhvilluar për shkaqe shëndetësore. Seanca tjetër e radhës është caktuar më datë 04.02.2013 dhe nuk është zhvilluar për arsye se pala e paditur ka paraqitur një kërkesë për shtyrje për shkaqe shëndetësore. Përfaqësuesi i palës paditëse ka qenë dakord që të shtyhet dhe përsëri nuk ka kërkuar që të shqyrtohet kërkesa për sigurim padie. Seanca e radhës është caktuar më datë 21.02.2013, ora 11:00. Kjo seancë nuk është shqyrtuar, pasi përfaqësuesi i palës paditëse ka kërkuar vetë të shtyhet gjykimi".*

³⁹ Që ka të bëjë me çështjen me palë paditëse F. K., palë e paditur AKKP, ZRVPP Sarandë dhe F. H. etj., me ndërhyrës kryesor Bashkia Konispol.

⁴⁰ Bëhet fjalë për çështjen me objekt: *"Anulimin e vendimit nr. {***}, datë 29.04.2004, të KKK Pronave të Qarkut Vlorë, si për themel, ashtu edhe për planvendosje. Detyrimin e të paditurit ta njohë pronar për një sipërfaqe 25 ha, të trajtuar në bazë të vendimit objekt padie. Lirimin dhe dorëzimin e tokës. Anulimin e urdhrit nr. {***}, datë 18.10.2004, të ZRVPP Sarandë dhe detyrimin e të paditurit ZRVPP Sarandë të fshijë nga regjistrimi kufizimin e vendosur".*

*dhe Kompensimit të Pronave apo Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, kjo çështje do të konsiderohet si mosmarrëveshje civile dhe do të shqyrtohet nga gjykata që ka kompetencë gjykimin e mosmarrëveshjeve civile”, është botuar në Fletore Zyrtare në muajin mars 2014, pra 2 muaj pasi subjekti ka dhënë vendimin e moskompetencës për gjykimin e çështjes që ankohet Bashkia Konispol. Lidhur me afatin e gjykimit të kësaj çështjeje nga subjekti, në tejkalim të afatit 6-mujor të parashikuar në vendimit nr. {***}, datë 14.4.2010, të KLD-së, “Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”, subjekti shpjegon se ajo ka ardhur për shkak të kompleksitetit që paraqiste kjo çështje, e cila edhe pas kthimit të saj për rigjykim⁴¹ në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë, është gjykuar për një afat 2 vjet e dy muaj, çka tregon e provon që kjo çështje është shumë komplekse dhe nuk mund të gjykohet brenda afatit 6 muaj, pasi do të cenonte kryerjen e një hetimi të plotë dhe gjithëpërfshirës.*

19.15. Lidhur me çështjen që i përket ankesës së Komunës Konispol, Kolegji konstaton se Komisioni ka mbajtur një qëndrim të ngjashëm si ai që ka mbajtur në rastin e analizës së ankesës së {***}, duke konsideruar se subjekti ka zvarritur procesin gjyqësor për shkak të mangësive të saj organizative dhe marrjes së vendimit për shpalljen e moskompetencës lëndore. Në këtë çështje, konstatohen rrethana të ngjashme për sa i përket historisë procedurale me atë të trajtuar më lart. Po në mënyrë të ngjashme, në kushtet e një paqartësie ligjore, subjekti ka marrë vendimin për moskompetencën lëndore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, pasi kishte kryer një proces gjyqësor me shumë seanca, të cilat duket se kanë qenë të kondicionuara për t’u shtyrë për një sërë shkaqesh procedurale të procesit. Edhe në këtë çështje, Kolegji vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Gentiana Xhelili, nuk rezulton të ketë zhvilluar aktivitet gjyqësor në kushtet e neglizhencës apo në shfaqje të mangësive të saj organizative. Duket se koha që ka marrë procesi, ka qenë e nevojshme për të siguruar mbarëvajtjen e një procesi kompleks e të drejtat e palëve përgjatë tij, për pasojë e gjen të padrejtë qëndrimin e Komisionit se subjekti ka shfaqur mangësi në aftësitë organizative, sipas nenit 74 të ligjit nr. 84/2016.

20. Në përfundim të kontrollit që iu bë vendimit të Komisionit lidhur me konkluzionet e kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, Kolegji arriti në përfundimet e mëposhtme.

20.1. Pasi mori në shqyrtim konkluzionet e arritura prej Komisionit e të përdorura prej tij për të argumentuar situatën e mangësive profesionale të subjektit në drejtim të indikatorit të aftësive organizative, sipas nenit 74 të ligjit nr. 96/2016, dhe i gjeti ato të pambështetura, Kolegji vlerësoi se problematikat e konstatuara në çështjen me palë paditëse E. K., E. B., V. B., K. B.e palë të paditur ZRVPP-ja Vlorë, ZQRPP-ja Tiranë, person i tretë Avokatura e Shtetit Vlorë, si dhe ato që lidhen me disa afate kohore të gjykimeve të cilat duken se janë në tejkalim të afateve rregullatore, nuk janë të mjaftueshme për të arritur në konkluzionin se subjekti ka shfaqur mangësi në drejtim të aftësive organizative, duke pasur në konsideratë faktin se këto problematika janë të lidhura me një ngarkesë pune të përballuar prej subjektit, në nivelin *pesëfish* të normës rregullatore të përcaktuar prej KLGj-së.

⁴¹ Si provë gjatë hetimit administrativ, subjekti ka paraqitur vendimin gjyqësor me nr. {***}, datë 11.07.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë .

20.2. Kolegji gjeti gjithashtu të pambështetur konkluzionin e Komisionit për sa u përket vendimmarrjeve të subjektit për shpalljen e moskompetencës lëndore në çështjet gjyqësore që lidhen me ankesën e {***} dhe ankesën e Bashkisë Konispol, si shfaqje të mangësive në drejtim të aftësive organizative, për sa kohë këto vendime janë marrë si pasojë vlerësimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Gentiana Xhelili, si gjyqtare e çështjes në kushtet e mungesës së një orientimi unifikues nga Gjykata e Lartë për përcaktimin të kompetencës lëndore të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm në raport me ato administrative.

20.3. Në këto kushte, Kolegji, duke vlerësuar të gjitha qëndrimet e Komisionit rreth vlerësimit të këtij kriteri, konstaton se nuk gjenden elemente/fakte që do ta çonin Kolegjin në konkluzionin se subjekti ka shfaqur mangësi në njohuritë ligjore apo edhe organizative. Në rastet e analizuara më lart, vetëm në çështjen që i përket familjes B., Kolegji u dakordësua me qëndrimin e mbajtur prej Komisionit se subjekti ka shfaqur mangësi në njohuritë organizative dhe nuk ndau të njëjtin qëndrim për dy çështjet e tjera, në të cilat Komisioni kishte gjetur gjithashtu shkelje të kësaj natyre, që u përkasin ankesave të {***} dhe Konispol. Ndërkohë që në vendimin e Komisionit, konstatohet se janë marrë në analizë edhe shumë çështje të tjera të gjykuara prej subjektit, po në drejtim të njohurive organizative, për të cilat Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit, znj. Gentiana Xhelili, ka kryer detyrën në konformitet me parashikimet ligjore dhe nuk ka konstatuar sjellje të saj që kanë shkaktuar zvarritjen e proceseve gjyqësore. Në këto rrethana, Kolegji, duke vlerësuar në mënyrë harmonike këto përfundime dhe ato që lidhen me çështjen e familjes B., në raport edhe me ngarkesën e punës së përballuar prej subjektit, arrin në konkluzionin se ajo ka arritur një nivel kualifikues në drejtim të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, në kuptim të nenit 59, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 84.2016.

21. Në përfundim, Kolegji mori në analizë edhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, me të cilat kërkon të konsiderohet *se nuk është i drejtë dhe i bazuar në ligj e në situatën faktike, konkluzioni i Komisionit se subjekti gjendet në kushtet e cenimit të besimit të publikut sipas përcaktimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.*

21.1. Lidhur me këtë shkak, Kolegji konstaton se në vendimin e Komisionit, është konkluduar se: *Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka mangësi në drejtim të aftësive organizative, si: për të përballuar ngarkesën e punës; plotësimin e standardeve minimale kohore; kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje në rendimentin e përfundimit të çështjeve gjyqësore; moskryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor; për mosshmangien e seancave gjyqësore joproductive; për të mos miradministruar dosjet gjyqësore duke u bazuar në rregullshmërinë, plotësinë dhe saktësinë e dokumentacionit të dosjes, ka aftësi minimale kualifikuese. Mangësitë e konstatuara më lart, Komisioni vlerëson se nuk mund të ngrihen në nivelin e shkarkimit sipas pikës 4 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, por duhen marrë në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes, duke u gjendur në kushtet e pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. [...]*

21.2. Kolegji, në referim të këtij konkluzioni të vendimit të Komisionit, vëren se mangësitë e gjendura në vlerësimin e aftësive profesionale, edhe pse në vlerësimin e këtij kriteri nuk janë

konsideruar se çojnë këtë organ drejt konkluzionit se subjekti ka mangësi në formimin profesional, në kuptim të nenit 44, pika “b” e ligjit nr. 84/2016, janë konsideruar si elemente që e çojnë atë drejt konkluzionit se subjekti ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, duke u gjendur në kushtet e parashikuara në nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Sipas vendimit të Komisionit, si elemente që kanë çuar këtë organ në konkluzionin se subjekti ka cenuar besimin e publikut, janë evidentuar: *mangësia për të përballuar ngarkesën e punës; plotësimin e standardeve minimale kohore; kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje në rendimentin e përfundimit të çështjeve gjyqësore.*

21.3. Në shqyrtim të këtij konkluzioni, Kolegji vëren se mungon një paraqitje dhe analizim i qartë i elementeve që e kanë çuar Komisionin në këtë qëndrim. Konstatohet se, edhe pse subjekti ka dhënë shpjegime mbi ecurinë e seancave gjyqësore, duke evidentuar arsyet për të cilat seancat janë shtyrë, duket se Komisioni nuk i ka konsideruar në analizë këto arsye⁴², por është mjaftuar vetëm me faktin se gjykimi ka zgjatur përtej afatit të parashikuar nga KLD-ja me vendimin nr. {***}, datë 14.04.2010, “Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”. Për më tepër, mbështetur në analizën e bërë më lart, Kolegji ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni për shkeljet e konsideruara prej tij në drejtim të kriterit të aftësive profesionale, duke mbetur e konfirmuar brenda këtij kriteri, vetëm një shkelje e konstatuar. Përgjithësimet e Komisionit për mangësi në aftësitë organizative, nuk u gjetën të bazuara nga Kolegji sipas arsytimit të bërë më sipër rreth kësaj çështjeje.

21.4. Për sa më sipër, Kolegji, në referim edhe të jurisprudencës së tij⁴³, nisur nga fakti që vendimi i Komisionit nuk ka arsyetim të qartë si ka ndikuar sjellja e subjektit në vonesat e shqyrtimit të dy çështjeve, ndër disa të analizuara, si dhe duke konsideruar faktin që numri i çështjeve të shqyrtuara në tërësi nga subjekti, është dukshëm shumë më i lartë se norma e numrit të çështjeve të përcaktuara nga KLD-ja, çmon se janë elemente/të dhëna që nuk mund të çojnë drejt konkluzionit për ta konsideruar subjektin si me mangësi për të përballuar ngarkesën e punës; plotësimin e standardeve minimale kohore, në ato nivele sa mund të konsiderohet se ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

21.5. Përveç sa më sipër, Kolegji sjell në vëmendje qëndrimin e mbajtur në jurisprudencën e tij, se analiza e të dhënave që rezultojnë vetëm nga një prej kriterëve të rivlerësimit, përveç rasteve tepër specifike, nuk mund të shërbejë në funksion të analizimit të përgjithshëm të tri kriterëve sipas nenit 2, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, i cili kërkon që të vlerësohen në harmoni të dhënat që burojnë nga vlerësimi i tri kriterëve të rivlerësimit, për të konkluduar eventualisht për cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.

21.6. Në këto kushte, Kolegji çmon se këto problematika që kanë shoqëruar punën e gjyqtarës, për sa kohë që nuk konsiderohen të mjaftueshme për ta kualifikuar subjektin e rivlerësimit, znj. Gentiana Xhelili, si të papërshtatshme në kuptim të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, nuk mund të konsiderohen apriori se kanë cenuar besimin e publikut te sistemi i

⁴² Shih paragrafët 276 dhe 277 të vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi, në të cilët analizohet ankesa e Bashkisë Konispol.

⁴³ Shih vendimin e Kolegjit nr. 28/2020 (JR).

drejtësisë dhe, për pasojë, vlerëson si të pabazuar konkluzionin e Komisionit se subjekti ka cenuar besimin e publikut, sipas parashikimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

22. Kolegji i konsideroi jorelevante dhe të panevojshme për t'u shqyrtuar shkaqet me natyrë procedurale të ngritura prej subjektit në vendim, për sa kohë që konkludoi në mënyrë të ndryshme nga Komisioni lidhur me çështjet që i adresoheshin vlerësimit të kriterëve të rivlerësimit dhe gjithë vendimmarrjes së Komisionit në tërësi.
23. Për sa më sipër, duke konsideruar se subjekti ka rezultuar se ka arritur nivel të besueshëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, së bashku me konkluzionin e arritur për një nivel të besueshëm në kriterin e kontrollit të figurës, Kolegji arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e nenit 59, pika 1, germa "a", "b", "c" të ligjit nr. 84/2016 dhe, në këto rrethana, vendimi i Komisionit duhet të ndryshohet, dhe ajo duhet të konfirmohet në detyrë.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa "b" e ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 369, datë 21.04.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Gentiana Xhelili.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 03.07.2023.

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

RELATORE

Ina RAMA

nënshkrimi

KRYESUESE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi – kundër

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtarja Rezarta Schuetz, nuk isha dakord me vendimin e shumicës së trupit gjykues dhe votova kundër ndryshimit të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), me nr. 369, datë 21.04.2021, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Gentiana Xhelili. Në vlerësimin tim, shkarkimi nga detyra duhet të ishte lënë në fuqi, pasi subjekti nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, kusht i përcaktuar në nenin 59, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016⁴⁴.
2. Vlerësova se subjekti i rivlerësimit paraqitet jobindës në pretendimet e tij për sa u përket disa aspekteve të kontrollit të pasurisë, e konkretisht, lidhur me: (i) ligjshmërinë e të ardhurave nga qiraja e një apartamenti, frytet e së cilës janë gëzuar nga subjekti, detyrimet fiskale të të cilave janë shlyer vetëm në momentin kur subjekti u njoh me çeljen e hetimit administrativ për rivlerësimin e tij; dhe me (ii) ekzistencën dhe ligjshmërinë e të ardhurave nga qiradhënia e një pasurie nga e cila subjekti deklaroi përfitime. Kjo pasuri, në pronësi të prindërve të bashkëshortit në {***} (Fier), deklarohet si burim krijimi pasurie i subjektit dhe bashkëshortit.
3. Në këtë kontekst, e gjeta të papranueshëm qëndrimin distancues të subjektit, që përpiqet të “përkulë” rrethanat ligjore në mënyrë që t’i vijnë përshtat situatës së tij në procesin e rivlerësimit, duke evituar çdo përgjegjësi individuale për mospagimin e detyrimeve fiskale deri në janar 2020, kur mësoi se nisi hetimi administrativ për të në Komision, nën argumentin e padijenisë, ndërkohë që përfitimet materiale prej tyre i ka njohur, dhe kërkon t’i njihen e përlllogariten në tërësi. Mungesa e dijenisë për mospagimin e detyrimeve për fitimet, ndërkohë që prej tyre ai derivon përfitime qoftë sipas deklarimeve të tij ndër vite, qoftë edhe në funksion të procesit të rivlerësimit, në kushtet që këto të ardhura janë deklaruar si burim për një llogari investimi në emër të tij, është jobindëse.
4. Së bashku me mungesën e burimeve të ligjshme për shpenzimet dhe investimet e kryera në disa nga vitet e periudhës së rivlerësimit, konstatuar edhe nga shumica, vlerësoj se balanca negative e konstatuar e vendos subjektin në kushtet e mosmbërritjes së pragut ligjor për konfirmimin në detyrë. Më poshtë, arsyetimi mbi të cilin bazohen konkluzionet e mësipërme, strukturuar sipas pasurive të deklaruara në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin [deklarata *vetting*].

I. Fondi i investimit 7,5 milionë lekë [afërsisht] dhe 133 mijë lekë [afërsisht] në emër të personit të lidhur/bashkëshortit

5. Subjekti i rivlerësimit ka blerë kuota në vlerën 7.556.000 lekë në një fond investimi, krijuar nga (i) *cash*-i prej 4 milionë lekësh, depozituar më 10 janar 2017, me burim kursimet nga pagat e saj dhe të bashkëshortit, (ii) 1,5 milionë lekë nga kursimet e personit të lidhur/bashkëshortit në një llogari në Raiffeisen Bank, me burim kursime nga paga dhe qiraja e apartamentit në Tiranë, pronë e prindërve të bashkëshortit, dhe (iii) afërsisht 2 milionë lekë, fituar prej saj nga ekzekutimi i një vendimi gjyqësor të janarit 2016. Nga analiza financiare e kryer në Komision,

⁴⁴ “[...] 1. Konfirmimi në detyrë i jepet subjektit të rivlerësimit në rast se plotësohen së bashku kushtet e mëposhtme: a) kur arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë [...]”.

subjekti rezultoi me pamundësi për të krijuar këtë fond në shumën (-) 3.552.438 lekë. Sipas analizës së kryer nga Komisioni, subjekti dhe personat e lidhur kanë qenë në pamundësi për të kryer shpenzimet dhe shtesat e kursimeve çdo vit, në harkun kohor 2011-2016.

6. Në përlllogaritjen e këtyre balancave negative, një vend kyç ka pasur vlera e deklaruar nga qiradhënia e një apartamenti që u përket prindërve të bashkëshortit të subjektit. Komisioni ka çmuar se në kushtet që tatimi mbi qiranë është paguar në janar 2020, vlera e përfituar nga qiraja [1.470.000 lekë] nuk përmbush kriterin e ligjshmërisë sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Po ashtu, Komisioni ka vlerësuar të mos përlllogaritë të ardhurat nga shitja e një pasurie në {***} [librari, shitur në prill 2006 në vlerën 1.400.000 lekë], të ruajtura e në gjendje ende pjesërisht në janar 2017 nga prindërit e bashkëshortit – për 11 vjet – siç pretendon subjekti, dhe të ardhurat në vlerën 1.470.000 lekë nga qiraja e një apartamenti në pronësi të tyre në Tiranë dhe nga qiraja e tokës bujqësore në {***} në vlerën 1.200.000 lekë.
7. Kam vlerësuar se ishte i drejtë konkluzioni i Komisionit për të tria këto aspekte. Për rrjedhojë, nuk isha dakord me shumicën në pranimin e pretendimit të subjektit për 300.000 lekë *cash*, të pretenduara të ruajtura për 11 vjet nga prindërit e bashkëshortit, të cilët nuk janë deklaruar në deklaratën e parë kur ata janë bërë pjesë në vitin 2011, sipas ligjit nr. 9049/2003. Po ashtu, nuk isha dakord me përfshirjen e shumës së fituar nga qiradhënia e apartamentit apo nga qiradhënia e tokës bujqësore për të njëjtat arsye sikurse edhe Komisioni. Nga kjo përlllogaritje, subjekti rezulton me mungesë burimesh në vlerën (-) 146.471 për vitin 2011, 743.268 lekë për vitin 2012, 670.701 lekë për vitin 2013, 1.109.578 lekë për vitin 2014, 294.477 lekë për vitin 2015 dhe 399.220 lekë për vitin 2016. [Totali: 3,2 milionë lekë afërsisht].
8. Së pari, në kushtet që subjekti i rivlerësimit, znj. Gentiana Xhelili, pretendon se ka jetuar në një ekonomi familjare që përfshinte edhe prindërit e bashkëshortit, më rezultojnë jobindëse gjithë pretendimet e saj, të cilat kanë për qëllim të atribuojnë burime të ardhurash prej tyre – për të cilat ajo nuk ka deklaruar ndër vite – ndërkohë që subjekti pretendon përfitim prej këtyre të ardhurave. Me fjalë të tjera dhe në të njëjtën linjë me qëndrimin tim në çështje të tjera⁴⁵, përpjekjet e subjekteve të rivlerësimit që sjellin në skenë si burim krijimi pasurish të ardhurat që u përkasin individëve për të cilët nuk kanë deklaruar domosdoshmërisht ndër vite si persona të lidhur, përbëjnë një inkoherencë në zbatimin e ligjit dhe një përpjekje për të përkulur kërkesat e ligjit në një formë që favorizon mungesën e transparencës për burimet financiare në dispozicion dhe mundëson evitimin e kontrollit rigoroz, të cilit subjektet parimisht duhet t'i nënshtrohen për shkak të nenit 179/b të Kushtetutës dhe nenit D të Aneksit të saj.
9. Si pasojë e një qasjeje të tillë, subjektet deklarojnë prurje të ardhurash të pagjurmueshme ndër vite, ndonëse flitet për individë me interesa financiarë të pandarë nga subjektet e rivlerësimit, të cilët kontribuojnë në mënyrë disproporcionale në favor të subjekteve, ndonëse përfitues të ardhurash modeste nga pensioni. Në rastin konkret, e gjej të pabesueshëm edhe pretendimin e subjektit, ngritur për herë të parë në deklaratën e pasurisë *vetting*, për *cash* të disponuar veçmas prej prindërve të bashkëshortit, i padeklaruar më parë, ndonëse ata jetojnë me subjektin, janë

⁴⁵ Për referencë, mendimin tim në pakicë në vendimin e Kolegjit me nr. 20/2023, që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit B. Maksuti, § 4 e 5, faqet 64 e në vijim.

një ekonomi familjare dhe në të njëjtën certifikatë, ndërkohë që po atyre u ngarkohet përgjegjësia për mosshlyerjen e detyrimeve tatimore ndaj buxhetit të shtetit për përfitime, frytet e të cilave i gëzon ekskluzivisht e në mënyrë të drejtpërdrejtë subjekti edhe personalisht, nëpërmjet fondit të investimeve apo llogarive bankare të personit të lidhur.

10. E konsideroj të pasinqertë e të papranueshëm pretendimin e subjektit për mungesë dijenie të mospagimit të detyrimeve tatimore, në kushtet kur në vazhdimësi, të ardhurat nga qiraja e apartamentit në Tiranë janë transferuar drejtpërdrejt në llogarinë e personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit për një periudhë kohore shtatë- (7-) vjeçare, ndërkohë që detyrimet tatimore janë shlyer vetëm në *janar 2020*. Mungesa e dijenisë së subjektit mund të pranohej *teorikisht* deri në vitin 2016, me miratimin e ndryshimeve kushtetuese që sollën rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve dhe ligjin nr. 84/2016. Duke filluar nga ky vit, mungesa e dijenisë së subjektit, edhe në nivel hipotetik, është e paargumentueshme, nën dritën e përcaktimeve të shprehura të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, dhe neneve 3/19 e 30 të ligjit nr. 84/2016, zbërthyer edhe me udhëzimin e Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së nr. 4095/2016. Në vijim të gjithë këtyre rregullimeve normative, në pikën fundore, subjekti do të duhet t'i kishte kushtuar kujdes shlyerjes së këtyre detyrime *më së paku* në momentin kur depozitoi deklaratën e pasurisë në janar 2017, ose përjashtimisht e si moment fundor, përpara çeljes së hetimit administrativ për rivlerësimin e saj, në mënyrë që të legjitimohej *teorikisht* padijenja e saj për problemet me ligjshmërinë e të ardhurave, frytet e të cilave ajo i gëzon ekskluzivisht me bashkëshortin. Këto veprime nuk kanë ndodhur. Detyrimet tatimore për të dyja marrëdhëniet juridike për të cilat subjekti deklaroi pasuri, janë shlyer vetëm pasi subjekti është bërë me dije se për të ka nisur procesi i rivlerësimit, nëpërmjet njoftimit të bërë nga Komisioni, në janar 2020, ose me fjalë të tjera, thuhet katër (4) vite pasi ishte miratuar kuadri kushtetues e ligjor për rivlerësimin dhe disa vite pasi kishte nisur procesi i rivlerësimit për subjekte të tjera. Në këto kushte, pretendimet e subjektit për *mungesë dijenie* të problemeve me ligjshmërinë e të ardhurave, bëhen edhe më të pakuptimta pasi është alogjike të argumentohet që ndërgjegjësimi për përcaktimet ligjore i ka ndodhur subjektit vetëm pasi Komisioni e njoftoi për nisjen e procesit, anëtarët e trupit gjykues të shortuar dhe pyetësozin standard⁴⁶.
11. Për gjithë sa më sipër, në kushtet që subjekti i rivlerësimit, znj. Gentiana Xhelili, vilte përfitime direkte nga pasuritë në emër të prindërve të bashkëshortit, pasi jetonte me ta, e deklaroi pasuri 50% të sajat të krijuara me këto të ardhura, minimalisht duhet të kishte zgjedhur të shëronte problematikën e detyrimeve tatimore me njohjen me kuadrin kushtetues e ligjor që passolli rivlerësimin kalimtar. Evitimin e detyrimit tatimor për pasuri nga të cilat subjekti përfiton, duke ua atribuuar problematikat individëve të tjerë me të cilët ajo jeton, nuk e vlerësoj si problem të shkaktuar nga individët e tjerë, por si një test të besueshmërisë së sjelljes së subjektit të rivlerësimit, që rezulton në mungesë mirëbesimi e transparence. Në panoramën e gjerë të rrethanave faktike, vlerësoj që pretendimet e ngritura nga subjekti, si përpjekje për të shpjeguar balancat negative, karakterizohen nga krijimi i artificave, me synim prezantimin e një

⁴⁶ Sipas vendimit të Komisionit, ky shkëmbim ka ndodhur në datën 13.01.2020, nëpërmjet postës elektronike. Shih § 5 dhe 6 të vendimit të Komisionit: <https://kpk.al/wp-content/uploads/2021/06/Vendim-G.-XHELILI-.pdf>.

interpretimi ligjor sipas të cilit ndërsa nga njëra anë subjektit i mundëson justifikimin e pasurive e begatimeve materiale, nga ana tjetër i shmang çdo përgjegjësi për ndonjë problematikë që u konstatua. Me fjalë të tjera, sipas këtij interpretimi të pranuar edhe nga shumica, të ardhurat e prindërve të bashkëshortit kanë vetëm efekt pozitiv për subjektin, në kushtet që passjellin shtim të ardhurash të disponueshme, ndërsa problemet me detyrimet me të cilat ato shoqërohen, janë barrë e individëve të tjerë dhe jo e subjektit e personit të lidhur.

12. Konstatohet që ky qëndrim i imi përputhet edhe me vendimin orientues të Kolegjit (JR) 15/2021, sipas të cilit, në vlerësimin e pagesave të vonuara të detyrimeve tatimore, duhet të merren në konsideratë, përpos të tjerash: (i) ekzistenca e të ardhurave, (ii) sjellja e subjektit dhe e personave të lidhur në funksion të pagimit të detyrimeve, si dhe (iii) rrethanat që kanë passjellë mospagimin e detyrimeve. Në rrethanat konkrete, subjekti ka jetuar me prindërit e bashkëshortit në një banesë, një ekonomi dhe certifikatë familjare, dhe ka pretenduar fitime prej këtyre të ardhurave, për të cilat nuk janë paguar detyrimet ndaj shtetit, duke i shlyer ato katër (4) vite pasi hyri në fuqi kuadri kushtetues e ligjor i rivlerësimit, e vetëm në momentin kur mësoi nisjen e hetimit administrativ për atë vetë, është e qartë që detyrimet tatimore janë shlyer për efekt të procesit të rivlerësimit. Në këto kushte, është e pamundur të argumentohet që veprimet e subjektit në vitin 2020, në funksion të hetimit administrativ, e çlirojnë atë nga përgjegjësitë dhe kthejnë të ardhurat në të ligjshme për qëllim të këtij procesi.

II. *Cash-i i deklaruar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, në vlerën 900 mijë lekë*

13. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti ka deklaruar po ashtu edhe *cash* në vlerën 900 mijë lekë [jashtë sistemit bankar], me burime nga (i) paga e subjektit, (ii) paga e bashkëshortit, (iii) pensionet e prindërve të bashkëshortit, (iii) qiraja e tokës bujqësore në emër të vjehrrit të subjektit, sipas Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi më 13.04.1992. Në kushtet që subjekti nuk deklaroi sa për qind të këtyre likuiditeteve e ka krijuar secili prej këtyre burimeve, është e pashpjegueshme se përse deklaroi se i përket 50% e këtyre të ardhurave, ndonëse në atë vlerë përfshihen *pensionet* e prindërve të bashkëshortit apo të ardhurat nga *qiraja* e tokës së tyre bujqësore, përfituar përpara martesës së saj ligjore në vitin 2008. Komisioni ka konkluduar se subjekti gjendej në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të mungesës së burimeve të ligjshme për të ardhurat nga qiraja e tokës bujqësore, deklaruar në vlerën 1,2 milionë lekë.
14. Pavarësisht nga disa kontradikta në mënyrën e arsytimit të Komisionit, në linjë me sa kam shtjelluar gjerësisht më sipër për mungesën e burimeve të ligjshme në disa vite për të krijuar fondin e investimit në janar 2017, për sa i përket pjesës që ka për burim *cash-in* e depozituar [në vlerën 4 milionë], vlerësoj që konkluzioni fundor i Komisionit është i drejtë edhe për këtë pasuri të deklaruar nga subjekti, për të dyja aspektet. Është po ashtu i drejtë konstatimi i Komisionit se subjekti ka qenë i pasaktë në deklarimin e *cash-it* ndër vite. Pretendimet e tij në hetim për mungesë qartësie e kthjelltësie gjatë viteve 2010 edhe 2011, apo për deklarimin e shtesave si gjendje, i konsideroj të pabazuara pasi janë në mospërputhje të hapur me deklaratimet e viteve të tjera, sikurse edhe me formimin profesional të subjektit si magjistrat.

15. Përpos sa më sipër, dhe çka është më e rëndësishme, vlerësoj se të ardhurat e deklaruara prej subjektit si burim krijimi i këtij likuiditeti – qiraja e tokës bujqësore në {***} – paraqesin probleme si për nga provueshmëria, ashtu edhe nga ligjshmëria e tyre për efekt të procesit të rivlerësimit. Së pari, ndryshe nga të ardhurat nga qiraja e banesës, të cilat janë shlyer në favor të personit të lidhur me subjektin/bashkëshortit nëpërmjet bankës, përfitimet nga qiraja e tokës bujqësore, në rastin më të mirë, janë deklarative. Së dyti, ndërsa në deklaratën *vetting*, subjekti i ka përcaktuar këto të ardhura për vetëm tre (3) vjet dhe në vlerën 900 mijë lekë, në përgjigje të pyetësorëve i ka korrigjuar duke i shtuar në vlerën 1,2 milionë lekë. Marrëdhënia e qirasë në fjalë, mes vjehrrit të subjektit dhe vëllait të tij, nuk është formalizuar përpara noterit.
16. Mënyra e deklarimit të këtyre të ardhurave ndër vite, krijon një panoramë sipas së cilës ato janë të ardhura të cilat u përkasin prindërve të bashkëshortit, ndonëse në vitin 2011 ka deklaruar të ardhura edhe bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit. Në vitet e tjera, as subjekti dhe as bashkëshorti nuk kanë deklaruar të ardhura. Nga ana tjetër, vjehri e vjehrra e subjektit kanë deklaruar të ardhura nga kjo kontratë për tri vite: 2011-2013, në rubrikën përkatëse të personave të lidhur me subjektin. Sikurse për qiratë nga apartamenti në Tiranë, në janar 2020, pasi subjekti mori pyetësorin e parë standard, është kryer një pagesë detyrimesh tatimore që përkon me vlerën 1,2 milionë lekë.
17. Në vijim të arsytimit të shtjelluar sa më sipër, vlerësova që këto të ardhura nuk u provuan në masën e deklaruar, por edhe nuk kalojnë pragun e ligjshmërisë së përcaktuar për procesin e rivlerësimit. Minimalisht, në momentin kur ka hartuar nën përgjegjësi deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti ka qenë i ndërgjegjshëm se jo vetëm po deklaronte të ardhura në vlerën *bruto*, që automatikisht përjashtojnë mundësinë që të jenë paguar detyrimet tatimore. Për sa më sipër, edhe këto të ardhura të deklaruara në *cash*, me prejardhje të pjesshme nga qiraja e tokës bujqësore, rezultojnë me mungesë burimesh të ligjshme, pasi subjekti ka rezultuar me balanca negative në disa vite, siç është shtjelluar gjerësisht më sipër, për pasurinë e numërtuar “I”.
18. Në përfundim, meqenëse subjekti gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme, parashikuar nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, votova për lënien në fuqi të vendimit objekt ankimi. Balanca negative që rezulton edhe duke u fokusuar në vetëm këto dy aspekte, nuk justifikon zbatimin e parimit të proporcionalitetit dhe kthimin e subjektit të rivlerësimit në detyrë.

GJYQTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi